# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6257
E shtunë, 6 mars 2021
çmimi 0.40 €

**Këtë muaj pritet të vijë në Kosovë vaksina kundër Covidit**




FAQE 7

Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

KMDLNJ

**KMDLNj-ja: Partitë e opozitës duhet të votojnë për qeverinë dhe presidentin** FAQE 7

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

KANË FILLUAR MANIFESTIMET PËR NDER TË 23-VJETORIT TË “EPOPESË SË UÇK-së” FAQE 4-5

# SAKRIFICA E ADEM JASHARIT, FRYMËZIMI MË I MADH PËR LIRI

Në 23-vjetorin e fillimit të “Epopesë së UÇK-së”, Kosova ka përkujtuar sakrificën për liri të komandantit legjendar Adem Jashari dhe familjes Jashari. Liderët institucionalë dhe politikë kanë vlerësuar lart këtë sakrificë, duke thënë se rezistenca e kësaj familje ishte frymëzimi më i madh për t’i rezistuar regjimit serb. Sipas tyre, kjo rezistencë dha alarmin për qendrat e vendimmarrjes botërore për të ofruar mbështetje për të vërtetën e Kosovës dhe popullit të saj



## OPINION

**7 MARSI, DITA KUR VEGOI DRITA E SHKËNDIJAVE TË DITURISË** F. 8-9

Hasan MUJAJ



**DIASPORA DUHET TË VOTOJË, POR EDHE TË DËGJOHET** F. 11

Nga Mimoza KELMENDI



## AKTUALE

**NËNSHKRUHET MARRËVESHJA PËR RENOVIMIN E FASADAVE TË SOLITERËVE NË LAGJEN ‘ULPIANA’** F. 6




## EKONOMI

**XHEVDET SMAKIQI ZGJEDHET KRYESHEF I POSTËS SË KOSOVËS** F. 9

**MOSPËRPUTHJE NË MES TË HOTIT DHE ATK-SË PËR TË HYRA** F. 9




FLET PËR “EPOKËN E RE”, FATMIR REXHEPI

## ELEKTORATI I LDK-së TREGOI KUSH NUK DUHET TA DREJTOJË PARTINË

Ish-deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Fatmir Rexhepi, ka thënë se kësaj partie i duhet një lider bashkues, i cili gëzon besimin e të gjitha gjeneratave. Në këtë intervistë dhënë gazetës “Epoka e re”, ai ka thënë se më 14 shkurt elektorati i LDK-së ka dhënë mesazhin se çfarë lideri i duhet kësaj partie. Sipas Rexhepit, kryetari i ri duhet të zgjedhet në mënyrë demokratike në Kuvendin Zgjedhor. Ai ka thënë se rezultati i zgjedhjeve për LDK-në ishte debakël politik. Ai ka numëruar arsyet që kanë sjellë këtë rezultat të dobët FAQE 3



## KOMUNITETET JOSERBE DORËZOJNË ANKESË NË PZAP

FAQE 8



RENOVA PUTZ
Maqedoni Xhepçisht –Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009 +389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website, Marketing...

## Nëntë të vdekur pas rrëzimit të një helikopteri të ushtrisë turke



ANKARA, 5 MARS - Një helikopter ushtarak është rrëzuar në lindje të Turqisë, ku humben jetën nëntë ushtarët në bord dhe u lënduan katër të tjerë. Lajmin e ka bërë me dije Ministria e Mbrojtjes e këtij shteti. Helikopteri u rrëzua në qytetin Tatvan, që është i banuar me shumicë kurde. Ky qytet gjendet në provincën Bitlis. Ende nuk është i qartë shkaku i këtij aksidenti. Helikopteri ushtarak, i tipit Cougar, ishte nisur për në Tatvan nga provinca Bingol. Ky helikopter u zhduk nga radari në orën 14:25 sipas kohës lokale, tha Ministria e Mbrojtjes. Ushtarët e lënduar janë evakuuar për në një spital, thanë autoritetet turke.

# PE-ja kërkon nisjen e negociatave me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut

BRUKSEL, 5 MARS - Në Komisionin për Politikë të Jashtme të Parlamentit Evropian janë miratuar raportet për Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut. Me këto raporte, duke marrë parasysh se janë përmbushur të gjitha kushtet, Parlamenti kërkoi që për të dyja shtetet të nisin negociatat e anëtarësimit pa vonesa të reja.

Sa i përket Shqipërisë, përmes këtij raporti është përshëndetur përkushtimi i Tiranës zyrtare për integrimin evropian, fqinjësi të mirë dhe zbatimin e reformave që lidhen me procesin e integrimeve.

Deputetët e Parlamentit Evropian kanë kërkuar që reformat në sistemin e drejtësisë të jenë të pakthyeshme sepse ato janë një prej kushteve kryesore për përparim në procesin e integrimeve. Eurodeputetë kanë kërkuar që zgjedhjet e muajt prill në Shqipëri të zhvillohen sipas standardeve demokratike, duke nënvizuar se ato do të jenë një test për konsolidimin e procedurave demokratike në vend dhe arritjes së stabilitetit të qëndrueshëm politik.

Në raportin për Maqedoninë e Veriut kërkohet që të vazhdohen përpjekjet për forcimin e demokracisë, për luftën kundër korrupsionit dhe të përmirësohet gjendja e lirisë së mediave dhe shoqërisë civile.

Eurodeputetët kanë shprehur mirënjohje për përkushtimin konstruktiv të Maqedonisë së Veriut për raporte të mira fqinjësore, përfshirë edhe zbatimin e Marrëveshjes së Prespës, në të njëjtën kohë kanë shprehur keqardhje për mungesën e një zgjidhje të çështjeve të hapura mes Maqedonisë së Veriut dhe Bullgarisë. PE-ja u ka bërë thirrje të dyja vendeve që përmes dialogut konstruktiv të kërkojnë një kompromis.



Të dyja këto shtete kandidate janë në pritje të nisjes së negociatave të anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Këshilli i BE-së tashmë ka marrë vendimin që t'i nisin bisedimet, por nuk ka caktuar datën se kur do të ndodhë një gjë e tillë.

Në rastin e Maqedonisë së Veriut kjo është bllokuar nga Bullgaria e cila ka parashtruar kërkesa që kanë të bëjnë me historinë dhe identitetin, për të cilat ka interpretime të ndryshme në Shkup dhe Sofje.

Për Shqipërinë, disa shtete anëtare duan të shohin më shumë përparim në reforma, luftë kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit dhe të shohin se si do të zhvillohet procesi zgjedhor për zgjedhjet e prillit.

# Shkalla e lindjeve në ShBA bie gjatë pandemisë



NJU-JORK, 5 MARS - Lindjet në Shtetet e Bashkuara kanë qenë në rënie për gati një dekadë, por në vitin 2019 është regjistruar numri më i vogël i foshnjave të lindura në 35 vjet, tregon një studim i Institutit "Brookings" me seli në Uashington.

Sipas studimit, rreth 300 000 foshnja më pak priten në vitin 2021.

Analiza vjen në kohën kur pandemia e koronavirusit ka trazuar tregun e punës, duke i dëmtuar në mënyrë disproporcionale gratë që punojnë.

Sipas Qendrës Kombëtare të Ligjit për Gratë, vitin e kaluar pjesëmarrja e grave në tregun e punës ka rënë për 57 për qind - niveli më i ulët që nga viti 1988.

Për shkak të mbylljes së shkollave si pasojë e pandemisë, miliona gra janë detyruar ta balancojnë mbikëqyrjen e fëmijëve me punë dhe përgjegjësitë e tjera.

"Kur tregu i punës është i dobët, niveli i përgjithshëm i lindjeve bie; kur tregu i punës përmirësohet, nivelet e lindjeve përmirësohen", shkruajnë autorët e studimit të Institutit "Brookings", Melissa Kearney dhe Philip Levine.

Numrat finalë për vitin 2020 nuk janë publikuar ende, por një përmbledhje e kanalit "CBS News" për 32 shtete amerikane tregon për 95 000 lindje më pak në vitin 2020 krahasuar me vitin paraprak.

## Tri tërmete në Zelandën e Re

WELLINGTON, 5 MARS - Tri tërmete, përfshirë një që ishte më i forti që ka goditur ndonjëherë rajonin, u regjistruan në Zelandën e Re të premten, duke ndezur edhe paralajmërime për tsunami. Mijëra njerëz janë evakuuar nga zonat bregdetare në ishullin verior, pasi tërmeti i tretë, me magnitudë 8.1, goditi rajonin. Ka pasur raporte për bllokime trafiku, ndërsa njerëzit përpiqeshin të arrinin terrene më të larta. Disa dallgë anormale goditën pjesë të bregut, por pasditen e të premtes autoritetet thanë se më e keqja kishte kaluar. Banorëve iu tha se mund të riktheheshin në shtëpi, por u paralajmëruan të qëndronin larg plazheve.




EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

FLET PËR “EPOKËN E RE”, FATMIR REXHEPI

# Elektorati i LDK-së tregoi kush nuk duhet ta drejtojë partinë

Ish-deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Fatmir Rexhepi, ka thënë se kësaj partie i duhet një lider bashkues, i cili gëzon besimin e të gjitha gjeneratave. Në këtë intervistë dhënë gazetës “Epoka e re”, ai ka thënë se më 14 shkurt elektorati i LDK-së ka dhënë mesazhin se çfarë lideri i duhet kësaj partie. Sipas Rexhepit, kryetari i ri duhet të zgjedhet në mënyrë demokratike në Kuvendin Zgjedhor. Ai ka thënë se rezultati i zgjedhjeve për LDK-në ishte debakël politik. Ai ka numëruar arsyet që kanë sjellë këtë rezultat të dobët



EPOKA E RE Muhamet KOCI

PRISHTINË, 5 MARS - Ish-deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Fatmir Rexhepi, ka treguar për hapat që duhet t’i ndërmarrë kjo parti për t’u përgatitur për zgjedhjet e ardhshme. Ai ka deklaruar se udhëheqja e partisë duhet ta lexojë mirë rezultatin e zgjedhjeve të 14 shkurtit.

Në këtë intervistë dhënë gazetës “Epoka e re”, Rexhepi ka deklaruar se LDK-së i duhet një lider bashkues. “LDK-së i duhet lider me performancë të pastër politike, figurë unifikuese dhe që gëzon besim te të gjitha gjeneratat, si dhe të zgjedhet në mënyrë demokratike në Kuvendin Zgjedhor”, ka thënë Rexhepi.

Ai ka deklaruar se më 14 shkurt elektorati i LDK-së ka dhënë mesazh të qartë për lidershipin e partisë. “Mesazhi i dhënë nga elektorati i LDK-së më 14 shkurt tregon më së miri se kush nuk duhet ta drejtojë partinë. Ai është mesazh për të gjithë ata që e kanë sjellë LDK-në para falimentimit politik, lideri dhe drejtuesit aktualë, sepse LDK-ja do ta kishte fatin e HDZ-së kroate”, ka deklaruar Rexhepi.

Ai ka thënë se rezultati i zgjedhjeve për LDK-në ishte debakël politik. Ai ka numëruar arsyet që e kanë sjell atë. “Po, ky është një rezultat katastrofal dhe debakël i plotë politik për lidershipin e LDK-së, për politikat, gabimet dhe mashtrimet e mëdha ndaj elektoratit si: koalicionet me PAN-in, rrezikimi me marrëveshjen për ‘Autonominë’ e serbëve duke e cenuar rendin kushtetues të vendit, me mosliberalizimin e vizave si dhe me rrëzimin e qeverisë në kohë pandemie në kundërshtim me vullnetin e elektoratit”, ka thënë ai.

Rexhepi ka bërë me dije se deputetët e LDK-së duhet ta votojnë Vjosa Osmanin për presidente. “Po. Sepse ky ishte edhe vullneti, besimi dhe mesazhi i qytetarëve të Kosovës më 14 shkurt. Por, është edhe si obligim kushtetues dhe përfaqësues për ndërtimin dhe forcimin e stabilitetit politik të institucioneve shtetërore të Republikës se Kosovës”, është shprehur Rexhepi.

**“Epoka e re”:** *Z. Rexhepi, cili është vlerësimi juaj për rezultatin e zgjedhjeve të 14 shkurtit?*

**Rexhepi:** Vlerësimi im shkon për qytetarët dhe organizimin e zgjedhjeve në një nga ditët me të vështira të këtij dimri. Zgjedhje demokratike, nga më të mirat në gjithë regjionin, duke dërguar mesazh pozitiv dhe afirmim të vlerave qytetare për të gjitha vendet e tjera demokratike. Rezultati është shprehje e vullnetit të votuesve për ndryshimin e filluar nga zgjedhjet e vitit 2019, për profil tjetër politik dhe shtetëror, për më shumë demokraci dhe shtet ligjor, për më shumë zhvillim dhe arsimim për organizim dhe përfaqësim më të mirë në diplomaci si dhe procese të tjera dialoguese dhe integruese.

**“Epoka e re”:** *Në këto zgjedhje, LDK-ja ka dalë me një rezultat shumë të ulët, prej 13-përqindësh. Çfarë mendoni se ka ndikuar në këtë rënie të LDK-së?*

**Rexhepi:** Po, ky është një rezultat katastrofal dhe debakël i plotë politik për lidershipin e LDK-së, për politikat, gabimet dhe mashtrimet e mëdha ndaj elektoratit si: koalicionet me PAN-in, rrezikimi me marrëveshjen për ‘Autonominë’ e serbëve duke e cenuar rendin kushtetues të vendit, me mosliberalizimin e vizave si dhe me rrëzimin e qeverisë në kohë pandemie në kundërshtim me vullnetin e elektoratit.

**“Epoka e re”:** *Si reflektim ndaj rezultatit zgjedhor, kryetari i kësaj partie ka ofruar dorëheqje. Si e keni parë këtë veprim të tij?*

**Rexhepi:** Jo, si duket dhe, si zakonisht, i kanë rënë pishman si lideri ashtu edhe kryesia. Tani kjo është tepër e vonuar, ‘post festum’! Por, unë, duke i parë zhvillimet e pritshme politike vitin e kaluar dhe në interes të LDK-së, e që të mos vijë në këtë situatë, publikisht pata kërkuar që në zgjedhjet e reja LDK-ja të mos hyjë me lidershipin aktual. Pra, që 23 dhjetori LDK-në ta gjente me kryetar dhe kryesi të re dhe të ecim në hapa me kohën dhe në pajtim me vullnetin e elektoratit. Por, për fat të keq, në alternativën time mbeta zë i vetmuar.

**“Epoka e re”:** *Si duhet të veprojë tani kjo parti.? Kush duhet të jetë kryetar i ri i kësaj partie?*

**Rexhepi:** Mesazhi i dhënë nga elektorati i LDK-së më 14 shkurt, tregon më së miri se kush nuk duhet të drejtojë partinë. Ai është mesazh për të gjithë ata që e kanë sjellë LDK-në para falimentimit politik, lideri si dhe drejtuesit aktualë, sepse LDK-ja do ta kishte fatin e HDZ-së kroate. LDK-së i duhet lider me performancë të pastër politike, figurë bashkuese dhe që gëzon besim te të gjitha gjeneratat si dhe të zgjedhet në mënyrë demokratike në Kuvendin Zgjedhor.

**“Epoka e re”:** *Ka zëra që thonë se znj. Vjosa Osmani duhet të kthehet në parti për ta udhëhequr. E shihni të mundshme një gjë të tillë?*

**Rexhepi:** Jo.

**“Epoka e re”:** *Nëse Vjosa Osmani vazhdon rrugën e saj drejt Presidencës, a duhet LDK-ja ta votojë për presidente të vendit?*

**Rexhepi:** Po. Sepse ky ishte edhe vullneti, besimi dhe mesazhi i qytetarëve të Kosovës më 14 shkurt. Por, është edhe si obligim kushtetues dhe përfaqësues për ndërtimin dhe forcimin e stabilitetit politik të institucioneve shtetërore të Republikës së Kosovës.



KANË FILLUAR MANIFESTIMET PËR NDER TË 23-VJETORIT TË “EPOPESË SË UÇK-SË”

# Sakrifica e Adem Jasharit, frymëzimi më i madh për liri

Në 23-vjetorin e fillimit të “Epopesë së UÇK-së”, Kosova ka përkujtuar sakrificën për liri të komandantit legjendar Adem Jashari dhe familjes Jashari. Liderët institucionalë dhe politikë kanë vlerësuar lart këtë sakrificë, duke thënë se rezistenca e kësaj familje ishte frymëzimi më i madh për t'i rezistuar regjimit serb. Sipas tyre, kjo rezistencë dha alarmin për qendrat e vendimmarrjes botërore për të ofruar mbështetje për të vërtetën e Kosovës dhe popullit të saj

EPOKA E RE Muhamet KOCI

PRISHTINË, 5 MARS - Liderët institucionalë dhe politikë të Kosovës kanë vlerësuar lart sakrificën e komandantit legjendar Adem Jashari dhe familjes së tij. Në 23-vjetorin e “Epopesë së UÇK-së”, ata kanë vlerësuar se sakrifica e kësaj familje ishte frymëzimi më i madh për liri.

Në manifestimin qendror, në kazermën “Adem Jashari” të FSK-së në Prishtinë, ushtruesja e detyrës e presidentes, Vjosa Osmani, ka thënë se 23 vjet më parë, në marsin e vitit 1998, Adem Jashari kishte përçuar mesazhin se liria nuk ka kompromis.

Para ushtarëve të FSK-së ajo ka thënë se brezat e ardhshëm do të jetojnë me shëmbëlltyrën e Adem Jasharit. “Të dashur ushtarë të forcës, po e shënojmë sot këtë përvjetor të epopesë në kazermën që mban emrin e komandantit Adem Jashari sepse ai është fryma, është ideja dhe është shpirti i forcës sonë, i forcës sonë të sigurisë, i ushtrisë sonë. Sot ju bartni mbi supe përgjegjësinë e sigurisë për qytetarët tanë për shtetin tonë”, ka thënë ajo. Sipas saj, sakrifica e familjes Jashari është unike në historinë e njerëzimit. “Ju e keni dëshmuar se keni kapacitete jo vetëm për ta transformuar FSK-në në ushtri, por edhe për ta bërë krenar vendin tonë - Kosovën - brenda dhe jashtë vendit. Sikurse Adem Jashari dikur, sot ju keni përpara misionin fisnik që ta ruani Kosovën, që ajo të mbetet një dhe e tërë, që ajo të mbetet e përhershme, sikurse dedikimi juaj dhe i yni njëkohësisht”, ka deklaruar Osmani.

Kurse kryeministri në detyrë i Republikës së Kosovës, Avdullah Hoti, ka thënë se akti i rezistencës së armatosur të Adem Jasharit me familjen dha frymëzimin e madh për t'i rezistuar një regjimi. “Këto tri ditë të rezistencës në Prekaz dhanë kushtrimin për popullin tonë për lirinë dhe pavarësinë, si dhe alarmin për qendrat e vendimmarrjes botërore për të ofruar mbështetje për të vërtetën e Kosovës dhe popullit të saj, për mbrojtjen e vlerave të qytetërimit perëndimor si dhe lirive dhe të drejtave fundamentale njerëzore”, ka deklaruar Hoti.

Kryeministri Hoti ka vlerësuar se Adem Jashari dhe anëtarët e tij të familjes u bënë emblema e vërtetë e ushtrisë së popullit. “Nga tradita jonë e lashtë, nga e cila na u bartën historitë tona, dëgjuam e lexuam rrëfime të shumta për të bëmat e figurave

→

## Mbi 1 milion analiza të bëra në Klinikën e Biokimisë



PRISHTINË, 5 MARS (ER) - Në Klinikën e Biokimisë të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës janë kryer më shumë se një milion analiza në vitin 2020, mes vështirësive të krijuara nga pandemia, nga një staf profesionistësh shëndetësorë, i cili, në pjesën më të madhe të kohës, ishte jo i plotë për shkak të infektimit me Covid-19. Sipas raportit të punës, në Klinikën e Biokimisë dhe në laboratorët brenda QKUK-së janë realizuar 1 milion e 9 mijë e 471 analiza për 246 mijë e 114 pacientë, një numër rekord i ofrimit të shërbimeve shëndetësore në kohë pandemie.

të shumta historike, por me një vlerësim racional mund të konstatojmë që rezistenca dhe sakrifica e familjes Jashari mban një vend unik. Kjo rezistencë është unike si nga qëllimi, ashtu edhe nga vlerat, dhe nga mesazhi hyjnor se dinjiteti njerëzor e familjar, si dhe liria kombëtare, janë të shenjta”, ka deklaruar ai.

I pranishëm në këtë ceremoni ka qenë edhe Bekim Jashari, djali i dëshmorit Hamëz Jashari. Në adresim e tij, ai ka thënë se në 23-vjetorin e epopesë Kosova kujton dhe nderon luftën e shenjtë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në krye me komandantin legjendar Adem Jashari. “Sakrificën e invalidëve dhe veteranëve të UÇK-së, familjeve të dëshmorëve e martirëve dhe gjithë ata që kontribuuan për lirinë e Kosovës, janë ata që shkruan historinë tonë të lavdishme, është vepra dhe heroizmi i tyre unik ai që vendosi të ardhmen e Kosovës. Sakrifica shekullore e popullit tonë, lufta dhe gjaku i derdhur ndër shekuj, është bazamenti i shtetit tonë demokratik të ndërtuar me shumë mund dhe sakrificë, pra shtetin që e krijuam falë atyre, që nuk kursyen as jetën, tani e kemi amanet që ta duam e ta zhvillojmë”, ka deklaruar ai.

Manifestimi i 23-të i “Epopesë së UÇK-së” është përmbyllur me parakalimin e kuadrateve të FSK-së dhe me ekzekutimin artistik të Orkestrës Frymore të FSK-së.

### Bëhen homazhe në kompleksin memorial

Në nderim të sakrificës së familjes Jashari, në 23-vjetorin e “Epopesë së UÇK-së”, disa liderë politikë kanë bërë homazhe edhe në kompleksin memorial “Adem Jashari”.

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Enver Hoxhaj, i shoqëruar nga anëtarët e kryesisë dhe bashkëpunëtorët, pas homazheve, ka deklaruar se më 5 mars të vitit 1998, me flijimin e familjes Jashari fitoi guximi mbi frikën, liria mbi okupimin dhe Kosova ndaj Serbisë. Ai ka thënë se Prekazi është epiqendra e lirisë, të cilën e gëzojmë sot si shtet sovran dhe i pavarur. “Me 5, 6 dhe 7 mars të atij viti u flijua familja Jashari për t’u ngritur në këmbë e tërë Kosova dhe i tërë populli shqiptar kudo. Flijimi dhe dashuria për atdheun tashmë e ka një majë, e ka një zenit, e ka një matës. Ajo quhet familja Jashari nga Prekazi dhe nuk ka ngjarje e cila mund ta tejkalojë këtë ngjarje historike të popullit shqiptar”, ka thënë ai.

Hoxhaj në emër të presidentit Thaçi dhe kryetarit Veseli ka vendosur lule te varret e familjes Jashari. “Gjykimi i tyre në Hagë është një tregues se sakrifica për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës ende nuk ka përfunduar. Por, ata edhe kësaj radhe do ta mbrojnë lirinë dhe pavarësinë tonë, duke u rikthyer sërish për të vendosur edhe fizikisht lule mbi varret e familjes Jashari”, ka theksuar Hoxhaj.

Lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka deklaruar se rruga e familjes Jashari është arritje për lirinë e plotë dhe forcim të vendit. Pas homazheve te varrezat e familjes Jashari, ai ka vlerësuar se përvjetori i rënies së kësaj familjeje është i rëndësishme për kombin dhe për proceset e mëdha të rajonit. “Jemi të bindur se duke ecur në këtë rrugë do ta arrijmë lirinë e plotë dhe ta forcojmë Kosovën. I dërguam përshëndetje familjes Jashari dhe gjithë të rënëve”, ka deklaruar ai.

Edhe kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka përkujtuar “Epopenë e UÇK”-së në 23-vjetorin e rënies heroike të Adem Jasharit dhe familjes Jashari. Limaj ka thënë se flijimi për liri i familjes Jashari është shembulli më unik, i cili “na kujton që, ajo që sot e gëzojmë, është rezultat i sakrificës së kësaj familjeje”.

“Më 5, 6 dhe 7 mars në Prekaz u ngritën themelet e shtetit tonë. Prekazi është vendi ku pavarësia dhe liria kanë marrë jetë dhe do të jetë në obligimin tonë gjithnjë për të qenë në shërbim të lirisë dhe pavarësisë së vendit tonë. Ne me pietet kujtojmë sakrificën e pashembullt të familjes Jashari në krye me komandantin legjendar Adem Jashari. Flijimi për liri i familjes Jashari është shembulli më unik, i cili na kujton që, ajo që sot e gëzojmë, është rezultat i sakrificës së kësaj familjeje”, ka thënë Limaj, i cili ka shtuar: “Epopeja e UÇK-së mobilizoi gjithë kombin shqiptar dhe bëri të mundur nisjen e një kthese historike për popullin shqiptar, e cila kulmoi me lirinë e Kosovës. Duke nderuar epopenë dhe familjen Jashari, nderojmë gjithë dëshmorët e rënë për lirinë e vendit tonë. Lavdi e përjetshme jetës dhe veprës së komandantit legjendar Adem Jashari, familjes së tij dhe gjithë dëshmorëve të kombit!”, ka thënë Limaj.

Për tri ditë në Kosovë shënohet 23-vjetori i Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Më 5, 6 dhe 7 mars në vitin 1998, në Prekaz të Komunës së Skenderajt, është zhvilluar një ndër betejat më të rëndësishme të UÇK-së kundër agresionit ushtarak të ish-Jugosllavisë.

Mëngjesin e 5 marsit të vitit 1998 forca të shumta serbe kishin sulmuar familjen e komandantit legjendar Adem Jashari dhe, pas një rezistence treditore, janë vrarë 55 persona, ku më shumë se 20 prej tyre ishin fëmijë dhe gra.

Ndër të rënët ishin komandanti legjendar i UÇK-së, Adem Jashari, vëlla i tij, Hamëz Jashari dhe babi i tyre, Shaban Jashari. Sakrifica e familjes Jashari në krye me Adem Jasharin në Kosovë vlerësohet si kthesë e madhe që i dha zgjidhje çështjes së Kosovës.





## Skenderaj shënon ‘Epopenë e UÇK’-së

Kuvendi Komunal i Skenderajt ka mbajtur seancë solemne me rastin e shënimit të 23-vjetorit të Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Kryesuesja e Kuvendit Komunal, Fatbardha Haliti, e ka vlerësuar lart kontributin e komandantit legjendar Adem Jashari dhe të familjes së tij. Haliti ka thënë se historia e marsit sjell kujtime të trishta, por edhe ndjenja krenarie. “Na sjell edhe porosi të mëdha që të punojmë e të angazhohemi për ndërtimin e shtetit, për promovimin e paqes kudo, duke krijuar kështu një të ardhme të qëndrueshme dhe të sigurt për të gjithë”, ka thënë Haliti. “Historia e lavdishme e popullit tonë në vazhdimësi ka dëshmuar se shqiptarët janë të patrembur para çdo armiku dhe se mund t’i mposhtin ata. Marsi na kthen mbrapa në kohë, te kulla e Jasharëve, aty ku u bë qëndresa heroike e stoike e familjes Jashari, aty ku baca Shaban, Hamza, komandanti legjendar Adem Jashari si dhe e gjithë familja luftoi ballë për ballë me forcat serbe deri në frymën e fundit, pa iu trembur fare syri”, ka thënë ajo.

## Arrestohen tetë policë të Kosovës



**Prishtinë, 5 mars (ER)** - Inspektorati Policor i Kosovës ka njoftuar se ka arrestuar tetë zyrtarë policorë, të dyshuar për vepra të ndryshme penale. Sipas njoftimit për media, operacioni i koduar “Jugu” u realizua në orët e hershme të mëngjesit në tre lokacione në Prishtinë. Të arrestuarit dyshohen për: “keqtrajtim gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare, cenim të së drejtës për ushtrimin e mjetit juridik, keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar, ushtrim ndikimi dhe falsifikim të dokumentit zyrtar”, thuhet në njoftimin e Inspektoratit Policor. Po ashtu, bëhet me dije se në cilësinë e provave janë konfiskuar gjësende të ndryshme.

Hetuesit e Inspektoratit paralajmëruan edhe veprime të tjera hetimore lidhur me këtë rast.

# Nënshkruhet marrëveshja për renovimin e fasadave të soliterave në lagjen 'Ulpiana'

PRISHTINË, 5 MARS (ER) - Kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti dhe drejtori ekzekutiv i Fondacionit të Mileniumit në Kosovë, Petrit Selimi, kanë nënshkruar marrëveshjen e mirëkuptimit për bashkëfinancimin e projektit për renovimin e fasadave të soliterave në lagjen "Ulpiana". Synimi i marrëveshjes është promovimi dhe bashkëpunimi i dy institucioneve për implementimin e projektit për efiçiencë elektrike në ndërtesat kolektive si pjesë e projektit për Peizazh të Besueshëm Energjetik (Reliable Energy Landscape Project ("RELP"). Ky investim do ta ndihmojë dukshëm reduktimin e energjisë që duhet shpenzuar për amvisëri dhe funksionalizimin e të gjitha instalimeve në këto ndërtesa, dhe me këtë edhe përmirësimin e cilësisë së ajrit në kryeqytet. "Falënderojmë Fondacionin e Mileniumit të Kosovës (Millennium Foundation Kosovo) dhe Korporatën e Sfidave të Mijëvjeçarit (Millennium Challenge Corporation - MCC) për mbështetjen dhe bashkëfinancimin e projektit në vlerë prej 1,758,085.55 eurosh", është theksuar në njoftimin e Komunës së Prishtinës.




## Ngrehet aktakuzë ndaj këshilltarit të kryetarit të Kllokotit

Gjilan, 5 mars (ER) - Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti për Krime të Rënda, ka ngritur aktakuzë kundër të pandehurit A. E. për shkak të veprës penale "Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar", nga neni 422, paragrafi 1 i Kodit Penal i Republikës së Kosovës. Sipas aktakuzës, në muajin janar të vitit 2018, në fshatin Pozheran, Komuna e Vitisë, i pandehuri A. E., si person zyrtar në pozitën e këshilltarit të kryetarit të Komunës së Kllokotit, duke shfrytëzuar pozitën e tij zyrtare, me qëllim të përfitimit material dhe shkaktimit të dëmit të operatorit ekonomik "NTP Blina", ka tejkaluar kompetencat e tij, në atë mënyrë që arrin marrëveshje verbale me përfaqësuesin e operatorit të lartcekur që të vendosë inventar në objektin e ri të komunës, duke i premtuar se më vonë do të zbatohen procedurat ligjore dhe do të bëhet pagesa nga Komuna e Kllokotit. Përfaqësuesi i operatorit ekonomik ka vendosur gjithë inventarin e porositur në objektin e ri të Komunës së Kllokotit dhe deri më tani nuk është realizuar asnjë pagesë nga komuna, me ç'rast të njëjtit i është dëm material në vlerë prej 4 460 eurosh. Me këto veprime, i pandehuri A. E. ka kryer veprën e sipërshënuar penale.



## Ministria e Infrastrukturës investon edhe në Fushë-Kosovë

Prishtinë, 5 mars (ER) - Ministri i Infrastrukturës, Arban Abrashi, të premten ka nënshkruar memorandum mirëkuptimi me Komunën e Fushë-Kosovës, përfaqësuar nga nënkryetari Fadil Krasniqi. Përmes këtij dokumenti, Ministria e Infrastrukturës do të financojë asfaltimin e rrugës nga ajo nacionale N9 deri te qendra e panaireve në Golesh. Ministria merr përsipër edhe financimin e rrugëve të lagjeve numër 28 dhe 29 të kësaj komune, që janë të banuara nga komuniteti egjiptian, ashkali dhe romë. Marrëveshje të tilla, përmes të cilave MI u del në ndihmë pothuajse të gjitha komunave për realizimin e projekteve infrastrukturore, janë tregues të një plani të mirëfilltë të punës së ministrit Abrashi, në të mirë të qytetarëve. Financimi do të bëhet në faza të ndara, përderisa dokumenti specifikon edhe përgjegjësitë komunale drejt realizimit të projekteve.



# Kompania gjermane 'Soilcos' do të hapë fabrikë për riciklimin e mbeturinave në Podujevë



PODUJEVË, 5 MARS (ER) - Kryetari i Komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi, ka pritur në takim pronarin e kompanisë "Soilcos" nga Gjermania, Jurgen Stainmuler, dhe përfaqësuesin e kësaj kompanie në Kosovë, Bekim Zejnullahu dhe Rejona Zejnullahu, drejtoreshë e Kompanisë "Erdi R Products".
Gjatë takimit me kryetarin Bulliqi, pronari i kompanisë gjermane Jurgen Stainmuler shprehu gatishmërinë të investojë në Podujevë, duke ofruar projektin për ndërtimin e fabrikës për riciklimin e mbeturinave dhe prodhimin e energjisë së ripërtëritshme. Me këtë rast kryetari Bulliqi ka shprehur gatishmërinë e plotë për përkrahjen e këtij projekti në aspektin administrativ dhe për ofrimin e kushteve infrastrukturore. "Përveç përfitimeve për në ruajtjen e ambientit dhe prodhimin e energjisë, me këtë projekt do të krijohen edhe shumë vende të reja pune për të rinjtë llapjanë", ka thënë Bulliqi.
Me realizimin e këtij projekti pritet të punësohen mbi 280 punëtorë, kurse kostoja totale e projektit është 55 milionë euro. Kryetari Bulliqi dhe investitori gjerman u pajtuan që menjëherë të fillohen procedurat për realizimin e projektit.

## Shefi i EULEX-it interesohet për gjendjen e sigurisë në Mitrovicë

MITROVICË, 5 MARS - Kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, ka pritur në takim shefin e ri të EULEX-it, Lars-Gunnar Wigemark, me të cilin ka biseduar për zhvillimet aktuale dhe gjendjen e sigurisë në qytetin e Mitrovicës.
Bahtiri, pasi vlerësoi lart bashkëpunimin e komunës me zyrtarët e EULEX-it, e njoftoi shefin e EULEX-it mbi gjendjen aktuale politike e të sigurisë në Mitrovicë, për të cilën tha se është e qetë dhe pa probleme. "Ne si komunë kemi pasur çdo herë bashkëpunim të shkëlqyeshëm me pjesëtarët e EULEX-it, andaj shpresoj që ky bashkëpunim korrekt të vazhdojë edhe më tutje, duke marrë parasysh që misioni juaj është shumë i rëndësishëm për shtetin tonë. Në qytetin e Mitrovicës janë bërë hapa të mëdhenj për stabilizimin e plotë të gjendjes së përgjithshme. Për këtë gjë u jam mirënjohës KFOR-it, Policisë së Kosovës, ambasadave, qytetarëve dhe të gjithë atyre që kontribuuan për ruajtjen e paqes në qytetin tonë", ka deklaruar Bahtiri.
Ndërkaq shefi i EULEX-it,



Gunnar Wigemark, u shpreh të jetë i kënaqur me të arriturat e qeverisjes komunale si dhe punën e kryetarit Bahtiri.

# KMDLNj: Partitë e opozitës duhet të votojnë për qeverinë dhe presidentin

Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj) ka kërkuar nga subjektet politike që institucionet e reja të formohen sa më shpejt. Ky këshill u ka bërë thirrje partive opozitare, PDK-së, LDK-së dhe AAK-së, të rrinë në sallë dhe të votojnë për zgjedhjen e kryeministrit, kabinetit qeveritar dhe për zgjedhjen e presidentit



EPOKA E RE Qendresa RAMA

**Prishtinë, 5 mars** - Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj) përmes një komunikate për media ka kërkuar nga subjektet politike që institucionet e reja të formohen sa më shpejt. Sipas KMDLNj-së, që nga përfundimi i luftës kurrë nuk ka pasur një situatë më të qartë dhe asnjëherë nuk ka qenë më lehtë që institucionet e Kosovës të formohen pa vonesë. "Partia fituese, LV-ja, që ka bërë koalicion me Listën 'Guxo', ka fituar afërsisht 50 për qind të votave të përgjithshme e që, përkthyer në deputetë, del t'i ketë fituar 58 mandate të deputetit. Me një fjalë, pas zgjedhjes së kryetarit/es dhe kryesisë së Kuvendit hapet rruga që të votohet edhe për kryeministër dhe kabinet qeveritar të Kosovës e që, sipas KMDLNj-së, është çështje e natyrës teknike. Është paralajmëruar mundësia që të ketë probleme gjatë zgjedhjes së presidentes për çka, sipas KMDLNj-së, duhet të ketë një marrëveshje politike dhe se opozita e ardhshme duhet ta dëshmojë konstruktivitetin opozitar duke mos e bllokuar këtë proces e që nënkupton se vendi duhet të shkojë në zgjedhje të reja për të cilat KMDLNj-ja vlerëson se janë krejtësisht të panevojshme dhe lehtësisht mund të shmangen", theksohet në komunikatën e KMDLNj-së.

Sipas këtij këshilli, kthimi i gjendjes në pikën zero vetëm sa i bën dëm Kosovës dhe proceseve nëpër të cilat duhet të kalojmë. "Realiteti i krijuar pas zgjedhjeve të 14 shkurtit 2021, ku fituesi i ka thuaja 50 për qind të votave dhe kur kandidata për president/e, znj. Vjosa Osmani, i ka afërsisht 310.000 vota, duhet të ngjallin respekt te partitë opozitare dhe duhet të respektohen këto vota sepse, demokracia matet me vota që janë përcaktuese për formim të institucioneve dhe pastaj, tregues i demokracisë gjatë qeverisjes është sjellja e pozitës ndaj opozitës dhe respektimi i saj. Pasi situata është qartësuar shumë e që pasqyrohet me fuqinë e votës, KMDLNj kërkon, që pas certifikimit të rezultatit të zgjedhjeve, të formohen të gjitha institucionet e Kosovës, pa bërë asnjë pengesë apo kushtëzim. Partitë opozitare, PDK-ja, LDK-ja dhe AAK-ja, sipas KMDLNj-së, jo që duhet të qëndrojnë në sallën e Kuvendit sa për ta bërë kuorumin e domosdoshëm, por duhet të votojnë të gjithë për zgjedhjen e kryeministrit, kabinetit qeveritar dhe presidentes, sipas propozimit të koalicionit fitues. Në këtë mënyrë opozita do ta respektonte parimin e demokracisë që vota është përcaktuese për formim të institucioneve e jo ndonjë kushtëzim eventual, do ta dëshmonte se është opozitë konstruktive, për shtetin dhe qytetarët dhe, pa asnjë dyshim, do ta fitonte një përparësi politike", është thënë në reagimin e KMDLNj-së.

Sipas KMDLNj-së, opozita e ardhshme me një qasje konstruktive në formimin e institucioneve do ta krijonte mundësinë që pozita ta fillojë realizimin e premtimeve dhe përgjegjësive e që, sipas KMDLNj-së, nuk janë aspak të lehta dhe se disa procese janë të pamundura të realizohen pa opozitën. "KMDLNj pret dhe kërkon që opozita të reflektojë në interes të shtetit dhe qytetarit duke votuar, pa asnjë rezervë dhe pa asnjë kusht, formimin e institucioneve të Kosovës. Realisht, tani e kemi një situatë ku pozita e ardhshme i merr të gjitha përgjegjësitë, kurse opozita e ardhshme është komode për faktin se nuk e merr asnjë përgjegjësi që i takon pozitës, por do të jetë korrigjuese e pozitës dhe, në këtë mënyrë, do të ketë mundësi të bëjë reforma brenda subjektit që e përfaqësojnë. Në një demokraci të qëndrueshme, funksionale dhe afirmative, pozita, pavarësisht fuqisë politike që e ka fituar, do të bënte përpjekje që ta mbajë opozitën afër. Në rastin konkret, pozita e ardhshme do të mund të ofronte postin e kryetarit të Kuvendit për opozitën e që aspak nuk do të ndikonte në humbjen e fuqisë politike të pozitës. Përkundrazi, vetëm sa do ta forconte pozitën", është theksuar në komunikatën e KMDLNj-së.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) të enjten ka shpallur rezultatin e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të 14 shkurtit. Sipas këtij rezultati, Lëvizja Vetëvendosje ka shënuar fitore bindëse, duke siguruar 58 ulëse në legjislaturën e re, ose 49.95 për qind të votave. Partia e dytë është renditur PDK-ja me 19 ulëse (16.90 për qind), e pasuar nga Lidhja Demokratike e Kosovës me 15 ulëse (12.64) dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës me 8 deputetë (7 për qind). Prej komuniteteve, Lista Serbe ka fituar dhjetë ulëse në Kuvend. Nga dy ulëse në Kuvendin e ri të Kosovës kanë fituar Partia Demokratike Turke e Kosovës dhe Iniciativa Rome. Ndërsa nga një ulëse kanë fituar Koalicioni Vakat, Komuniteti i Bashkuar Adrijana Hoxhiq, Partia e Re Demokratike, Partia Gorane, Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës dhe Partia e Ashkalinjve për Integrim.

# Këtë muaj pritet të vijë në Kosovë vaksina kundër Covidit

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

**Prishtinë, 5 mars** - Kryeministri në detyrë, Avdullah Hoti, ka bërë me dije se këtë muaj pritet të arrijë kontingjenti i parë prej 33 mijë dozave të vaksinës COVAX, ku Republika e Kosovës do të përfitojë 100 800 doza të vaksinës kundër Covid-19. Këtë lajm Hoti e dha të premten gjatë takimit që pati me ministrin e Shëndetësisë, Armend Zemaj, përfaqësuesit e IKShPK-së dhe atë të ShSKUK-së, me të cilët ka biseduar për situatën epidemiologjike kundër Covid-19. "Sa i përket furnizimit me vaksina, gjatë këtij muaji pritet të arrijë kontingjenti i parë prej 33 mijë dozave të vaksinës COVAX. Nga ky mekanizëm Kosova do të përfitojë 100 800 doza të vaksinës anti Covid-19, ndërkohë që jemi duke u zhvilluar negociata intensive edhe me prodhues të tjerë për ta siguruar numrin e nevojshëm të vaksinave me qëllim të imunizimit të plotë të popullsisë", ka deklaruar Hoti.




Ai ka thënë se vendi gjendet para një vale të re të shpërthimit të pandemisë Covid-19 dhe ka kërkuar mirëmbajtjen e masave në fuqi dhe respektimin e plotë të tyre. "Institucionet shëndetësore janë duke punuar intensivisht për rritjen e kapaciteteve, sigurimin e barnave dhe rritjen e numrit të personelit mjekësor. Nga shtabet komunale, policia, AVUK-u dhe Inspektoratet, kërkuam që ta rritin angazhimin për parandalimin, menaxhimin dhe kontrollin e infeksionit Covid-19 dhe në të njëjtën kohë ta bëjnë respektimin rigoroz të masave në fuqi", ka thënë Hoti.

Ai ka kërkuar nga qytetarët që ta respektojnë distancën fizike, t'i përdorin maskat, të bëhet dezinfektimi dhe ajrosja e lokaleve, duke pamundësuar përhapjen eventuale të infeksionit dhe shmangien e përhapjes në hapësirat e mbyllura.

Edhe komiteti për vlerësimin dhe koordinimin e situatës epidemiologjike kundër Covid-19 ka kërkuar të enjten mirëmbajtjen e masave në fuqi kundër Covid-19 dhe respektimin e tyre të plotë.

Në takimin e këtij Komiteti të drejtuar nga ministri në detyrë i Shëndetësisë, Armend Zemaj, u kërkua nga institucionet monitoruese dhe mbikëqyrëse që ta rritin angazhimin për respektimin rigoroz të masave në fuqi. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se gjatë 24 orëve të fundit kanë ndërruar jetë shtatë persona si pasojë e infektimit me Covid-19. Po ashtu, ky institut ka njoftuar se gjatë kësaj periudhe kohore janë paraqitur 564 rastet e reja me Covid dhe janë shëruar 380 persona.

# Diaspora duhet të votojë, por edhe të dëgjohet



Nga Mimoza KELMENDI

Ish-kryeministri i Shqipërisë, Pendeli Majko, ditë më parë u shpreh se nëse KQZ-ja nuk do ta bëjë realitet votën e diasporës, kjo çështje do të nxisë reagime dhe pakënaqësi në radhët e tyre. “Mendoj se KQZ-ja nuk duhet ta konsiderojë veten si forum partiak. KQZ-ja e ka punën e vet, partitë kanë punën e tyre”, ka theksuar ministri për Diasporën.

Ka disa shkaqe themelore që e bëjnë të domosdoshëm realizimin e votës së shqiptarëve kudo që jetojnë. Së pari, ata i takojnë vendit të tyre dhe janë të interesuar drejtpërsëdrejti në zhvillimet politike, financiare, shoqërore dhe ekonomike të atdheut, nga i cili janë larguar, në shumicën dërrmuese, gjeografikisht por, jo shpirtërisht. Lidhjet me Shqipërinë vazhdojnë të jenë të fuqishme dhe, në të njëjtën kohë, të rëndësishme. Askush, për arsye burokratike apo çështje teknike, nuk ka të drejtë t'i ndërpresë këto lidhje. Së dyti, jashtë Shqipërisë jetojnë sot rreth një e treta e popullsisë, e cila nuk ka shumë kohë që është larguar dhe nuk i ka humbur lidhjet me njerëzit, krahinën nga vijnë, përfaqësuesit dhe, mbi të gjitha, me familjet e tyre. Këto lidhje njerëzore, përmes votimit, pasurohen dhe nuk duhet të ndërpriten.

Së treti, megjithëse, si shumica e shqiptarëve, edhe te migrantët ndihet një dozë politizimi, ndoshta ngaqë nuk kanë shumë kohë të larguar, përsëri mendimi i tyre politik dhe qëndrimi ndaj ngjarjeve, forcave politike, personaliteteve, lëvizjeve të reja apo tradicionale, janë më të larguara nga përplasjet, mllefi dhe skajimi në çështje që mund të shtrohen. Duke qenë disi të larguar nga mjedisi ku votohet dhe ku përplasjet janë gjithnjë në rritje dhe, nga ana tjetër, më të qetë në gjykimin e tyre, vlera e votës së shqiptarëve në emigrim është edhe masive, edhe cilësore.

Ky nuk është një fenomen thjeshtë i yni. Vende të tjera e kanë kaluar, disa janë në rrugën e zgjedhjes, si në Kosovë, të tjerë po bëjnë përpjekje për të qenë sa më fleksibël.

Roli i migrantëve është i ndjeshëm në botë, njëjtë si në Shqipëri. 81 milionë migrantë jetojnë tashmë në Evropë, ndërsa në Gjermani jetojnë rreth 13 milionë, ndër ta edhe 700 mijë shqiptarë, të cilët kanë ardhur nga të gjitha viset. Ata janë larguar nga shtëpitë e tyre si pasojë e konflikteve, pasigurisë apo varfërisë me shpresë për një jetë më të sigurt dhe më të mirë në një atdhe të ri. Shuma e përgjithshme, që dërgohet çdo vit nga migrantët në familjet e tyre në atdhe, është kthyer në një faktor ekonomik. Ajo është gati tri herë sa ndihma për zhvillim që japin vendet e pasura. Banka Botërore (sipas të dhënave të vitit 2018), e vlerëson shumën e transfertave të migrantëve në të gjithë botën në 470 miliardë dollarë në vit. Remitancat kontribuojnë në zhvillimin e vendeve të origjinës së migrantëve, por paratë shpenzohen kryesisht për konsum dhe jo për investime produktive.

Prandaj sot është fakt që diaspora duhet trajtuar si partner për zhvillimin e Shqipërisë dhe jo vetëm si burim financash sa për të mbijetuar. Ajo që bie në sy kohët e fundit është përpjekja e qeverisë shqiptare për të ngritur një sistem për lehtësimin e votës së emigrantëve, një sistem të besueshëm që vota e shqiptarëve jashtë atdheut të garantohet e të lexohet me drejtësi dhe ndershmëri. Por vetëm Ministri i Diasporës është i prerë në kërkimin e votës së shqiptarëve që jetojnë jashtë vendit pasi, sipas tij, ka ardhur koha që edhe ata të marrin fatin e tyre në dorë. Publiku i gjerë, brenda dhe jashtë vendit, ka kohë që diskuton domosdoshmërinë apo jo të votës së diasporës shqiptare. Kërkesa e shtetasve shqiptarë që banojnë jashtë vendit për të votuar në atdhe ka qenë gjithmonë një dëshirë e shumëshprehur dhe e kërkuar vazhdimisht.

Por a mjafton thjesht vetëm një votim? A nuk ka ardhur koha që diaspora të dëgjohet dhe të përfaqësohet deri në Parlament? Mosrealizmi i premtimit të votës për emigrantët në vendet ku banojnë nga të gjitha krahët e politikës, mosreagimi i KQZ-së në afatin e duhur, me gjithë thirrjet e qeverisë për t'ua mundësuar shqiptarëve jashtë dhënien e votës, është thjesht një tjetër zhgënjim ndaj Diasporës. Ne shqiptarët jashtë nuk jemi vetëm numra dhe nuk duam që këto numra të shfrytëzohen edhe për votim thjesht si numra. Ne jemi një Shqipëri e vërtetë, ashtu siç thotë edhe Kadare. Ndaj kemi të drejtë të votojmë, të dëgjojmë, të diskutojmë dhe të kritikojmë. Madje kemi të drejtë të jemi edhe në Parlament. Sepse, siç ka deklaruar vetë ministri Majko: “Kur flasim për diasporën, flasim për një cilësi kombëtare”.

Problemi themelor që shtrohet qëndron në aksiomën se “nuk ka votim pa përfaqësim”. Nëse diaspora do të trajtohet si objekt financiar dhe jo si subjekt i zhvillimit dhe i një vizioni të ri, atëherë edhe vetë votimi nuk do të ketë vlerat e pritura. Shqipëria, në traditën e hershme parlamentare, ka pasur gjithnjë vende të rezervuara për ato që janë quajtur koloni shqiptare, megjithëse të pakta, jo kaq masive, por cilësore dhe gjithë përfaqësuese. Ka ardhur koha, sidomos me zhvillimet cilësore dhe personalitetet shqiptare që janë në botë, të ligjërohet saktësisht, jo vetëm votimi, por edhe përfaqësimi.

# Komunitetet joserbe dorëzojnë ankesë në PZAP

PRISHTINË, 5 MARS - Partitë nga komunitetet joserbe në Kosovë kanë dorëzuar të premten ankesë në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), duke kërkuar që të anulohen votat e komunitetit serb për partitë boshnjake dhe rome në zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 14 shkurtit.

Përfaqësuesit politikë të komunitetit boshnjak, rom, ashkali dhe egjiptas, pretendojnë se partia boshnjake “Komuniteti i Bashkuar Adrijana Hoxhiq” dhe “Iniciativa Rome” kanë siguruar vota në zgjedhjet e 14 shkurtit me ndihmën e Listës Serbe.

Duda Bale nga Unioni Socialdemokrat, e cila, sipas rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve, nuk arriti të fitojë ulëse, tha se komunitetet joserbe janë të gatshme që këtë çështje ta dërgojnë deri në Gjykatën Kushtetuese, nëse PZAP-ja dhe më pas Gjykata Supreme i hedhin poshtë pretendimet e tyre.

Ehat Miftaraj nga Instituti i Kosovës për Drejtësi, institut ky që u ka ofruar ndihmë juridike falas komuniteteve joserbe, tha se bëhet fjalë për manipulimin e



rreth 10 mijë votave. “Në bazë të ankesës që kemi përgatitur, kemi shkelje, në radhë të parë, të vullnetit të qytetarëve të komuniteteve joshumicë, kemi një manipulim të orkestruar nga Lista Serbe me disa parti boshnjake dhe rome. Janë afërsisht rreth 10 mijë vota, që kanë kaluar nga komuniteti serb te së paku dy parti të komuniteteve joshumicë”, ka deklaruar Miftaraj.

Komunitetet joserbe thonë se “Iniciativa Rome” dhe “Komuniteti i Bashkuar Adrijana Hoxhiq”, në zgjedhjet e 14 shkurtit kanë marrë vota në vendbanime ku nuk jetojnë të këtyre komuniteteve.

Sipas rezultatit të shpallur nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, “Iniciativa Rome” ka fituar dy ulëse në kuvend, ndërkaq partia boshnjake, “Komuniteti i Bashkuar Adrijana Hoxhiq”, ka fituar një ulëse. Sipas rezultatit, “Komuniteti i Bashkuar Adrijana Hoxhiq” ka fituar 6 422 vota, ndërkaq “Iniciativa Rome” ka siguruar 4 049 vota.

Hoxhiq, ndonëse ka pranuar se ka marrë vota nga mjediset me shumicë serbe, ka hedhur poshtë akuzat se ato i janë siguruar nga Lista Serbe.

Enver Hasani, ish-kryetar i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, ka vlerësuar se ankesat e komuniteteve janë krejtësisht të bazuara.

Norma kushtetuese, siç tha ai, i garanton përfaqësim efektiv secilit komunitet në vend. Sipas Kushtetutës së Kosovës, komuniteti boshnjak i ka të garantuara tri ulëse në Kuvendin e Kosovës. Komuniteti turk ka të garantuara dy ulëse, ndërkaq për përfaqësuesit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptas, janë të garantuara nga një ulëse si dhe një ulëse shtesë për njërën nga këto komunitete, që fiton më së shumti vota. Një ulëse të garantuar i takon edhe komunitetit goran.

→

# Mospërputhje në mes të Hotit dhe ATK-së




**Prishtinë, 5 mars** - Deklarimet e kryeministrit në detyrë të Kosovës, Avdullah Hoti, se ekonomia e Kosovës po kthehet në normalitet nga pandemia, bien ndesh me të dhënat zyrtare të Administratës Tatimore të Kosovës (ATK). Më 30 janar, kryeministri në detyrë, Avdullah Hoti, në një shkrim publikuar në rrjetin social "Facebook", ka thënë se ekonomia e Kosovës "po i kthehet normalitetit" dhe se "qarkullimi i bizneseve është rritur dukshëm". Ai shtoi se të hyrat nga Administrata Tatimore e Kosovës në janar 2021 janë të ngjashme me janarin e vitit 2020. Por, nga të dhënat që ATK-ja i ka dërguar "Radios Evropa e Lirë" nuk figuron se të hyrat janë të ngjashme. Sipas këtyre të dhënave të ATK-së, në janar të vitit 2020 qarkullimi i bizneseve ka qenë 815,402,903 euro, ndërsa në janar 2021 ka qenë 363,625,827 euro, që i bie 451,777,076 më pak.

Ndërkaq, për të hyrat nga Doganat e Kosovës, Hoti ka thënë se në janar 2021 janë 11 për qind më të larta se të janarit 2020, kur nuk ka pasur pandemi dhe kufizime.

Sipas të dhënave të Doganave të Kosovës dërguar "Radios Evropa e Lirë", thuhet se ka pasur rritje të të hyrave për 10 për qind. "Të hyrat për këtë periudhë (janar 2021) janë 155 milionë euro, që nënkupton rritje me vitin e kaluar me 10 për qind, pasi gjatë vitit 2020 kishim të mbledhura 140 milionë euro", thuhet në të dhënat e Doganave të Kosovës.

Të pyetur nga REL se pse është shënuar kjo rritje e të hyrave, Doganat e Kosovës nuk kanë dhënë ndonjë shpjegim.

Kryeministri në detyrë, Hoti, kishte thënë se ekonomia e Kosovës po kthehet në normalitet si rezultat i Pakos së Rimëkëmbjes për vitin 2020 prej 365 milionë eurosh, Ligjit për Rimëkëmbje që ka mobilizuar menjëherë në dhjetor mbi 200 milionë euro për qytetarë, Pakos së Rimëkëmbjes për vitin 2021 në shumën prej 222 milionë eurosh që ka nisur të zbatohet, si dhe efektit të shpenzimeve të diasporës në dhjetor të vitit të kaluar.

## Paratë e Trustit, një infuzion i përkohshëm

Sa i përket Ligjit për Rimëkëmbje Ekonomike, i cili mundësoi tërheqjen e 10-përqindëshit të Trustit të Kursimeve Pensionale nga qytetarët kontributpagues, sipas kryetarit të Aleancës Kosovare të Biznesit, Agim Shahini, ka qenë një infuzion i përkohshëm. Ai thotë se në muajin janar paratë e Trustit kanë ndikuar në rritjen e qarkullimit të bizneseve, por ato mjete tani janë limituar, pasi që shumica vetëm kanë tërhequr paratë dhe i kanë shpenzuar në janar. "Viti ka filluar mbarë, por tash kur nuk ka mjete në qarkullim nga Trusti si dhe diaspora është reduktuar me investimet e veta në Kosovë, pritet që të kthehemi prapë në gjendjen që kemi qenë vitin e kaluar. Sipas analizave tona, për rimëkëmbje ekonomike duhet dy deri në tri vjet dhe kjo varet nga qeveria e ardhshme se çfarë prioritete do të ketë në programin qeverisës", ka deklaruar ai.

## Mbi 420 mijë qytetarë tërhoqën 10-përqindëshin nga Trusti

Janë afër 200 milionë euro që janë tërhequr nga mbi 420 mijë qytetarët kontributpagues në Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës, ka bërë me dije për REL, Jeton Demi, zëdhënës në këtë institucion. Ai ka thënë se procesi i aplikimit po vazhdon ende, por me intensitet të ulët, me rreth 100 aplikime në ditë. Afati i fundit për aplikim është më 6 prill 2021.

Vlera e mjeteve në Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës ka arritur në mbi 2 miliardë euro me rreth 690 mijë kontributpagues. Ndryshe, si pasojë e Covid-19, Fondi Monetar Ndërkombëtar, në raportin e fundit të publikuar në shkurt të këtij viti, ka vlerësuar se Kosova në vitin 2020 ka shënuar rënie të ekonomisë deri në 6 për qind. Ndërkaq, ky mekanizëm financiar ndërkombëtar ka paraparë rritje ekonomike në vitin 2021 jo më shumë se deri në 4.5 për qind.

# Xhevdet Smakiqi zgjedhet kryeshef i Postës së Kosovës

**Prishtinë, 5 mars (ER)** - Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve të Postës së Kosovës ka përzgjedhur në pozitën e kryeshefit ekzekutiv, Xhevet Smakiqi, konfrom nenit 21 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike përmes konkursit publik. "Bordi ka udhëhequr një proces transparent, të drejtë për të gjithë kandidatët që kanë aplikuar, ndërsa ka përzgjedhur kandidatin më të përshtatshëm profesionalisht, z. Xhevdet Smakiqi, i cili ka mbi 15 vjet përvojë menaxhuese në Postën e Kosovës", thuhet në njoftimin për media të Postës së Kosovës. Në këtë njoftim është theksuar se gjatë intervistës së kandidatëve, Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve kishte ftuar për monitorim organizatën BIRN për të qenë më transparent në tërë këtë proces, ndërsa ka në dispozicion për secilin organizatë apo media të interesuar çdo dokument për secilin kandidat, deri në vendimin e përzgjedhjes. "Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve është i vetëdijshëm për gjendjen e ndërmarrjes publike, Posta e Kosovës, andaj përzgjedhja e kryeshefit ekzekutiv ka qenë nevojë e domosdoshme për të ushtruar një lidership dhe menaxhment të besueshëm dhe që përballon sfidat e kësaj periudhe. Ky vendim do të ndikojë në përmirësimin e vendimmarrjes, e cila ka qenë që një vit pothuajse me ushtrues detyre si pozitë kyçe e ndërmarrjes", është thënë në këtë njoftim.



# 7 marsi, dita kur vegoi drita e shkëndijave të diturisë

"Themelin e diturisë dhe të atdhetarisë e përbën gjuha shqipe" / *Mithat Frashëri*



Hasan MUJAJ

Shtatë marsi i vitit 1887 shënoi ditën vigane dhe vezulluese të burimit të vrullshëm dituror për gjuhën shqipe dhe për shqiptarët. Ditë e shenjtë e historisë kombëtare, e cila i shpuri përpara labërgimin dhe ravijëzimin e hullive të para të arsimit kombëtar.
Ecuria historike e shkollës shqipe është e gjatë. Shumë e gjatë. Ajo është e mbushur me emra theroresh zulmëmëdhenj, të cilët ndërtuan themelin e patrandur të vatrave të mësimit e të edukimit në gjuhën shqipe. Në historiografinë shqiptare dëshmohet se disa shkolla shqipe janë hapur që nga gjysma e parë e shek. XVII, madje edhe më herët. Me iniciativën e Andrea Bogdanit një shkollë shqipe ka punuar edhe në Janjevë të Kosovës në vitin 1665 mësues i së cilës qe prifti Pjetër Mazreku.
Në kërkimin e gjurmëve historike të arsimit shqip, do përmendur edhe shkolla e Voskopojës, e quajtur Akademia e Re në gjysmën e dytë të shek. XVIII, 1750. Kjo Akademi, që drejtohej nga Teodor Kavalioti, u ngrit në rangun e shkollës së mesme dhe bëri jehonë të madhe për arsimimin në gjuhën shqipe. Pasi e pa misionin e ndritur kombëtar të kësaj shkolle, pushteti turk mori masa represive ndaj saj: ndoqi mësimdhënësit, dogji bibliotekën shumë të pasur të shkollës, rrënoi konviktin e nxënësve, mori shtypshkronjën etj. dhe asgjësoi veprimtarinë e mëtejme të saj. Zhvillimi i shpejtë dhe lartësimi i kësaj shkolle u mor si shkas që Voskopoja, asokohe një nga qendrat më të njohura tregtare në Ballkan, të rrënohej nga pushtimi osman aq sa u shndërrua në një fshat të rëndomtë e të varfër ashtu siç është edhe sot.
Shëmbëlltyrat e ndritura të Rilindjes Kombëtare Shqiptare në krye me Naum Veqilharxhin si në vend, ashtu edhe në kolonitë shqiptare të mërgimit, duke e parë rëndësinë e madhe kombëtare të shkollës shqipe, me të drejtë ndërmorën një veprimtari të thukët me anën e së cilës shtruan kërkesat e ngutshme për t'i hapur shkollat në gjuhën shqipe, të vetëdijshëm se kështu hapnin horizonte të reja morale, persuasive dhe edukative të zgjimit të vetëdijes kombëtare si parakusht parësor për të përforcuar lëvizjen kombëtare për pavarësinë e Shqipërisë. Si pikënisje e këtij përforcimi, ishte parë arsimimi. Andaj, përkushtimi i lëvizjes kombëtare me shumë arsye ishte përqendruar në veprimtarinë e zhvillimit të arsimit në gjuhën shqipe. Filozofi i shquar gjerman - Hegeli, për rëndësinë e arsimit, me të drejtë kishte shkruar: "Arsimi është arti që e bën njeriun etik". Më se e vërtetë. Hapja e shkollave në gjuhën shqipe qe prioritet i rilindësve shqiptarë.
Përpjekjet për të vënë themelin e shkollës shqipe sa vinin e shtoheshin. Ato gjithnjë merrnin përmasa të një shtrirjeje më të gjerë e më përmbajtjesore për t'u kurorëzuar me sukses më 7 mars të vitit 1887 kur u hap shkolla shqipe në Korçë, që shënoi një arritje të madhe të lëvizjes kombëtare. Kësaj arritjeje historike, hapjes së shkollës shqipe në Korçë, i këndoi me të madh galdim edhe poeti e mendimtari i madh - Naim Frashëri:"Lumja ti moj Korçë moj lule, që lë pas shoqet e tua".
Nga vargjet e N. Frashërit, tek spikat patosi i stilit eliptik dhe apelativ, mund të kuptohet se poeti synonte ta afirmonte arritjen e Korçës edhe në krahinat e tjera me qëllimin nxitës që hapja e shollave shqipe të merrej si çështje me përparësi të veçantë. Prandaj, "shoqet" e Korçës duhej të nxitonin për ta zënë Korçën. Pandeli Sotirit i takoi nderi i madh të ishte mësues i parë i kësaj shkolle.
Interesimi për shkollat në gjuhën shqipe sa vinte e po ngrihej si një nga veprimtaritë më relevante të Rilindjes Shqiptare. Katër vjet më pas, në tetor të vitit 1891, po në Korçë, nga iniciativa e motrave Sevasti e Parasqevi Qiriazi si dhe e vëllait të tyre Gjerasim Qiriazi, me ndihmën e madhe edhe të Naim Frashërit, u hap Shkolla shqipe e vashave. Duke e ndjekur me përkushtim këtë mision të lartë drite, disa shkolla u hapën edhe në krahinën e Kolonjës.

## Shkolla Normale Shqipe e Bukureshtit

Duke e ndjekur themelimin dhe funksionimin e shkollave shqipe edhe jashtë trojeve etnike, do vënë në dukje se kontributi i mërgatës shqiptare për të hapur shkolla në gjuhën shqipe qe i thukët, pragmatik dhe i madh. Tejet i madh. Ky kontribut u dëshmua në vepër në vitin 1892 kur, me veprimtarinë e vazhdueshme të Shoqërisë Kulturore Shqiptare "Drita" të Bukureshtit, ku kishin mërguar me mijëra shqiptarë, u hap një shkollë e mesme edhe në gjuhën shqipe e quajtur Normalja e Bukureshtit, në të cilën mësimi zhvillohej në gjuhën shqipe dhe në gjuhën rumune.
Drejtor i Normales së Bukureshtit u zgjodh veprimtari i shquar i arsimimit shqip nga Korça - Nikolla Naço (1841 - 1913). Në këtë shkollë jepnin mësim edhe profesorë universitarë. Shkolla e kishte edhe konviktin e nxënësve. Aty ndoqën mësimet, ndër të tjerë, edhe: Dervish Hima, Jashar Erebara, Mihal Grameno, Aleks Stavri Drenova, Lasgush Poradeci, Shahin Kolonja etj., të cilët, siç dihet, u bënë emra të mëdhenj të veprimtarisë kombëtare, letrare dhe publicistike të Rilindjes Shqiptare. Prandaj, aksiomë është se shtatëmbëdhjetë vjet përpara Normales së Elbasanit për të cilën në shumë tekste shkollore pa të drejtë thuhet se është shkolla e parë e mesme shqipe, i kishte hapur dyert Normalja e Bukureshtit tek u përgatitën mësuesit e parë shqiptarë.

## Normalja e Elbasanit

Normalja e Elbasanit, e cila filloi punën më 1 dhjetor të vitit 1909, shënoi një arritje të madhe në fushën e arsimit shqip. Ajo u bë vatra më dritëdhënëse e arsimit dhe e edukimit të asaj kohe. Drejtor i parë i saj qe Luigj Gurakuqi. Në këtë shkollë dhanë mësim studiues dhe krijues të spikatur të shkencës së gjuhës e të letërsisë shqipe si p.sh.: Luigj Gurakuqi, Aleksandër Xhuvani, Kostaq Cipo, Sotir Peci, Simon Shuteriqi, Qamil Guranjaku etj. Në të mësonin nxënës krahinash të ndryshme shqiptare , një numër i madh i të cilëve ishte nga Kosova, të dërguar në këtë shkollë me iniciativën e me përkrahjen e Hasan Prishtinës dhe të përkushtimit të tij të madh për të siguruar kuadër- mësimdhënës me qëllimin për të hapur shkolla në gjuhën shqipe edhe në Kosovë. Normalja e Elbasanit botonte edhe gazetën "Normalisti".
Shkollat shqipe, në bashkërendim me shoqëritë kulturore, me gazetat e revistat brenda dhe jashtë Shqipërisë, gjatë Rilindjes Kombëtare Shqiptare, qenë gurrë e pashtershme e zgjimit dhe e thellimit të vetëdijes kombëtare dhe vatra ndriçuese e orientuese të veprimtarisë për të sendërtuar Shqipërinë e pavarur. Me gjithë masat ndëshkuese të pushtimit osman, të patrikanës greke dhe të qarqeve të tjera antishqiptare, të cilat shpesh përfundonin me vrasjet e mësuesve e të shkrimtarëve shqiptarë si p.sh.: Pandeli Sotiri, Pjetër Nin Luarasi, Papa Kristo Nrgovani, Luigj Gurakuqi, Shtjefën Gjeçovi etj., veprimtaritë arsimore, publicistike, kulturore e atdhetare etj. nuk u ndalën asnjëherë. Përkundrazi. Ato vazhduan të veprojnë duke u bërë edhe më masive dhe më jehuese; këto veprimtari zhvilluan e ndoqën misionin e madh kombëtar që ia kishin vënë vetes dhe ai ishte: trupëzimi i pavarësinë e Shqipërisë.

## Therorë të shollës shqipe

Sikundër është shkruar e dëshmuar edhe me të dhëna statistikore në publikimet e ndryshme të vendit dhe madje edhe ndërkombëtare, politika antishqiptare e Beogradit zyrtar, në fillim të viteve '90, përqendroi dhunën veçanërisht mbi arsimin e Kosovës në gjuhën shqipe të të gjitha niveleve: filloi me helmimin e nxënësve dhe të mësimdhënësve, mbylli me dhunë policore objektet shkollore e universitare dhe i ruante me tanke për të mos hyrë nxënësit e studentët, ndaloi financimin, burgosi e vrau shumë arsimtarë e masa të tjera represive.
Ndonëse në rrethana të këtilla dhune, mësimdhënëset e mësimdhënësit shqiptarë, heroinat e heronjtë e kultivimit të dijes e të edukimit, nuk u ndalën së vepruari as në gjendjen e jashtëzakonshme të rrethimit policor: të mbështetur edhe nga populli, vazhduan zhvillimin e mësimit në shtëpitë private në bashkërendim me qytetarët dhe kudo qenë të mirëpritur. Edhe pse të ndjekur e të burgosu ngar pushteti policor serb, arsimtaret e arsimtarët, të organizuar në asociacionin Lidhja e Arsimtarëve Shqiptarë "Naim Frashëri", qenë të parët që braktisën dokumentacionin administrativ të mëparshëm dhe futën në përdorim dëftesat e nxënësve me vulën e Republikës së Kosovës. Ky veprim qe përcaktim i prerë i arsimtareve dhe i arsimtarëve, i dëshmoreve dhe i dëshmorëve të dijes për pavarësimin e shkollës shqipe nga diktati i politikës serbe. Njëherësh qe pararendje e përgatitjes morale e strategjike që lufta paqësore e penës të kalonte në luftën e armës; shumë arsimtare e arsimtarë kapën pushkën dhe u bënë bashkë me astritët e UCK-së në luftën për lirinë e pavarësinë e Kosovës.
Shteti i diktaturës autarkike serbe nuk arriti dot ta asgjësonte këtë veprimtari të shenjtë të diturisë dhe këtë përcaktim të patrandur të shqiptarëve për Kosovën shtet të pavarur. Jo. Assesi. Përkundrazi. Rezistenca sa vinte e ngrihej lart edhe pse pati viktima të mësuesve shqiptarë - therorë të shkollës shqipe që u vranë nga policia serbe si p. sh.: Fazli Greiçevci, Haki Pavata, Feriz Blakçori, Halit Geci e shumë të tjerë, të cilët prore do të mbesin ndër shëmbëlltyrat më të ndritura kombëtare. Dhe jo vetëm kaq.
Viktima të shkollës shqipe janë edhe veprimtarët e lëvizjes kombëtare të viteve '90 që u vunë në mbrojtjen e kësaj vatre diturore siç ishte rasti i tre dëshmorëve të Uçës së Istogut: Muharrem Hyseni, Hasan Hysenaj dhe Bajram Hoxhaj, të cilët, derisa po kërkonin hapjen e shkollave që i kishte mbyllur regjimi komunist i Beogradit, u vranë nga policia serbe më 31 janar të vitit 1992.

## Të ngrihet cilësia arsimore dhe edukative

Sipas testit ndërkombëtar të cilësisë - Pisa dhe të instancave të tjera të jashtme e të brendshme që e ndjekin ecurinë e cilësisë së mësimit, dihet se arsimi i Kosovës është radhitur në shkallë të ulët. Prandaj, shtrohet si detyrë e ngutshme e institucioneve kompetente që të bëjnë hapa konkretë rreth ngritjes së cilësisë në arsim. Një nga masat efektive do të ishte p.sh. themelimi i shërbimit profesional -didaktik në nivelin e komunave nga ekspertët me përvojë të arsimit. Shërbimet e këtilla, që funksionojnë në shumë shtete të Perëndimit, do të zhvillonin bashkërendim të ngushtë me mësimdhënësit me qëllim që të ngrihet cilësia e arsimit dhe e edukimit. Në Zvicër p. sh. këshilltarët pedagogjikë marrin pjesë edhe në orët e mësimit për të parë në praktikë zhvillimin e ecurisë metodike të njësisë mësimore, përgatitjen profesionale e didaktike të arsimtares ose të arsimtarit, interesimin e angazhimin e nxënësve etj. Këshilltari, më pas, bën konsultime me mësimdhënësen - mësimdhënësin dhe shkruan vlerësimin me shkrim me sugjerimet profesionale e metodologjike të strategjive të reja të mësimdhënies moderne.
Në Kosovë nuk ndiqet kjo strategji shumë efektive e veprimtarisë arsimore. Mbikëqyrja nga drejtori i shkollës, që praktikohet në shumë shkolla të vendit, nuk është profesionale. Këshilltarët pedagogjikë janë profesionalisht kompetentë për ngritjen e cilësisë. Nuk është e thënë të ketë këshilltarë të këtillë për të gjitha lëndët, por, sidomos për gjuhën shqipe dhe për matematikë, është domosdoshmëri!
Thënia e Mithat Frashërit, në fillim të këtij shkrimi, është porosi e madhe me domethënie të përhershme. E vërtetë e padiskutueshme. Prandaj, duhet të ndërtohet themeli i diturisë. Ai themel, pa asnjë dyshim, është gjuha shqipe. Themeli i fortë, ndërtesa e sigurt sado që të ngrihet lart. Për ta mësuar mirë gjuhën amtare, duhet të zhvillohet edukimi gjuhësor që nga niveli parashkollor e në vijimësi më tej. Sepse, pikërisht nga lënda Gjuhë e letërsi shqipe rezultati i testit ishte nën nivelin e duhur.
Vlen të mbahet përherë parasysh mendimi i filozofit italian të gjuhës, Benedeto Kroçe: "Quaj njeri atë që është zot i gjuhës amtare!"

# Padrejtësi speciale në emër të drejtësisë së dështuar



Shkruan: Adil BEHRAMAJ

Te drama e Shekspirit, Hamleti, heroi, është një njeri i virtytshëm, që tronditet me të drejtë nga ngritja e papritur në pushtet e një sundimtari djallëzor. I përndjekur nga vizione, i pushtuar nga makthe, i vetmuar dhe i mënjanuar, ai ndien se duhet ta rindërtojë të kuptuarit e kohës për të. "Koha ka dalë nga kyçet", thotë Hamleti!

Edhe në Kosovë koha ka dalë nga kyçet. Por, tek ne, me ndërhyrje politike, kohën e nxori nga kyçet drejtësia e tredhur ndërkombëtare. Tash, shumëkush, përfshirë edhe vetë bashkësinë ndërkombëtare, duhet ta rindërtojë të kuptuarit e saj.

Drejtori ekzekutiv i Shkollës së Çështjeve Publike dhe Ndërkombëtare në Universitetin e Baltimores, profesori i njohur Ivan Sascha Sheehan, me një editorial të publikuar në "News Week" goditi Bashkimin Evropian, i cili Gjykatën Speciale e ka shndërruar në mjet për t'i kthyer pikëpamjet e veta në vepër, duke i eliminuar politikanët me të cilët nuk pajtohet. Pra, nga një gjykatë që synonte të administronte drejtësinë për krimet e së kaluarës, ajo tashmë është bërë mjet i bashkësisë ndërkombëtare për politikën e saj në të tashmen, duke e administruar padrejtësinë.

Gjithmonë ka hapësirë për ta shtruar pyetjen: sa e vërtetë është e vërteta? Por, e pakontestueshme si e vërtetë është që nuk ekziston asnjë shtet në botë, që ka qenë më bashkëpunues me bashkësinë ndërkombëtare sesa Kosova. Shteti ynë sot është 13 vjeçar, por deri vonë ishte një foshnje e ndërkombëtarëve, që provuan ta rrisnin me "kujdestarët" me të këqij të tyre: UNMIK-un dhe EULEX-in.

Krimet e pretenduara se janë kryer gjatë luftës në Kosovë janë hetuar nga gjashtë nivele të ndryshme gjyqësore: vendore, rajonale dhe ndërkombëtare. Ato u hetuan dhe gjykuan nga Tribunali Penal Ndërkombëtar për Ish-Jugosllavinë, nga UNMIK-u, EULEX-i, Prokuroria Speciale e Kosovës (Departamenti për Krime Lufte) dhe gjykatat e Republikës së Kosovës. Krimet e pretenduara të shqiptarëve u fabrikuan, u hetuan dhe u gjykuan edhe nga vetë Serbia, e cila barbarisht kreu mijëra krime në Kosovë. Ato i hetoi dhe gjykoi Departamenti për Krime të Luftës në Gjykatën e Lartë të Beogradit. Por, për të mos u mjaftuar me kaq, ato u hetuan dhe po gjykohen edhe nga seria e gjykimeve me juridiksion të përzier të drejtësisë vendore dhe ndërkombëtare.

Gjykata Speciale përbën shkallën e shtatë të hetimeve dhe gjykimeve të krimeve të luftës, që pretendohen se janë kryer nga ish-pjesëtarë të UÇK-së.

Në zhargonin profesional ato janë gjykuar nga tri gjykata paradigmatike: Ndërkombëtare, domestike dhe modele hibride, siç janë një pjesë e vendimeve të UNMIK-ut, EULEX-it dhe tash Gjykata Speciale.

Pra, krahasuar me çdo shtet, jo vetëm të ish-Jugosllavisë, por kudo që ka pasur konflikte të armatosura dhe luftëra në botë, lufta e UÇK-së ka kaluar nëpër filtra të shumëfishtë ndërkombëtarë dhe është shqyrtuar shumë herë nga mekanizmat më të avancuar të hetimeve të tyre.

Sipas të dhënave më të konsoliduara, nga 1 janari 1998 deri më 31 dhjetor 2000, rezulton se janë vrarë dhe zhdukur gjithsej 10 812 shqiptarë, 2 197 serbë, 526 romë, boshnjakë, malazez dhe komunitete tjera joshqiptare. Këtu nuk përfshihen humbjet e jetës së fëmijëve dhe të moshuarve që kanë ndodhur për shkak të rrethanave të luftës dhe deportimit masiv nga shtëpitë e tyre të rreth 1 milion shqiptarëve. Nga forcat serbe, po ashtu, janë dhunuar edhe rreth 20 mijë femra shqiptare. Të gjitha këto krime kanë ndodhur në një territor që krejtësisht ishte i kontrolluar nga forcat serbe. Dhe, nëse krahasojmë numrin e viktimave dhe përgjegjësinë strukturore e komanduese, niveli i gjykimeve ndaj autoriteteve serbe për krimet e kryera, jo vetëm që qëndron në shpërputhje të thellë, por është edhe fyes për viktimat, familjet e tyre dhe tërë popullin e Kosovës.

Që nga përfundimi i luftës, drejtësia ndërkombëtare në emër të drejtësisë tranzicionale ka pasur qasje të papenguar në terren, në dosje dhe në dëshmitarë, me përgjegjësi absolute për zbardhjen e të gjitha rasteve. Çdo shqiptar i akuzuar prej tyre, sikurse askund në botë ka bashkëpunuar me drejtësinë ndërkombëtare, e cila i ka gjykuar dhe rigjykuar, siç nuk ndodh askund tjetër. Edhe vetë liderët shtetërorë të Kosovës, sikurse edhe në të kaluarën, sapo ua konfirmuan aktakuzat, dhanë dorëheqje dhe iu dorëzuan Gjykatës Speciale. Ndërsa, jo shumë larg nga Kosova, të gjitha shtetet e ish-Jugosllavisë që i kanë kaluar luftërat e nisura nga Serbia, shumë më shpejt e kanë kaluar drejtësinë tranzicionale, duke mos qenë fare bashkëpunuese me drejtësinë ndërkombëtare. Autoritetet serbe me vite të tëra i fshehën të kërkuarit e tyre nga Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë, si Karaxhiqin, Mlladiqin, Milloshevriqin, etj. Madje, disave prej tyre, shteti serb ua kishte ndërruar edhe identitetin për t'i fshehur. Pra, nuk u kanë ofruar as qasje të papenguar në terren dhe drejtësinë ndërkombëtare e kanë sabotuar tërësisht, por ironikisht shumë më lehtë kanë kaluar.

Bombardimi 78 ditorë nuk mund të trajtohet si dënim që bashkësia ndërkombëtare ia ka dhënë Serbisë. Kjo nuk është drejtësi për viktimat shqiptare të luftës. Nuk është drejtësi as për Kosovën. Kriminelët serbë tash shëtisin lirshëm, jo vetëm nëpër Serbi, por në çdo shtet të Bashkimit Evropian. Ata i ushtrojnë edhe funksionet më të larta në Serbi, siç janë rasti i Vuçiqit si ish-ministër i Milloshevriqit apo i Daçiqit si ish-zëdhënës i atij regjimi kriminal. Ndërsa, populli ynë, viktimë e krimeve të tyre, ndonëse Kosova ka plotësuar dyfish më shumë kritere se çdo shtet tjetër i liberalizuar, vazhdon ende të gjykohet dhe të mbetet i izoluar.

Edhe nevoja për themelimin e Gjykatës Speciale ka ardhur më së shumti si dështim i bashkësisë ndërkombëtare, sepse deri në vitin 2018 i kishin kompetencat e plota në sistemin e drejtësisë në Kosovë. Duke marrë paga të majme të taksapaguesve evropianë, asaj i interesonte vetëm ruajtja e sigurisë dhe stabilitetit politik. Ndërsa, as që ka bërë përpjekje minimaliste ndonjëherë për të siguruar drejtësi për viktimat e luftës. Sot, më shumë ka shqiptarë të gjykuar e dënuar në Kosovë për krime të luftës, se serbë në Kosovë e Serbi. Më krim për drejtësinë ndërkombëtare gjithnjë ka rezultuar të jetë se kush/kujt ia ka dhënë ndonjë shuplakë para dy dekadash në Kosovë, se masakrimi dhe vrasja e mbi 10 mijë shqiptarëve në mënyrë të organizuar dhe sistematike nga shteti serb. Krimet serbe mbi shqiptarët tashmë nga drejtësia ndërkombëtare po trajtohen vetëm si statistikë e luftës!

Jofunksionaliteti i drejtësisë ndërkombëtare dhe lojaliteti i lidershipit të Kosovës e ka sjellë edhe Gjykatën Speciale, e cila çdoherë e më shumë po dëshmohet si mjet politik për politikanë të padëgjueshëm dhe si nevojë e krimit të burokratëve evropianë me "jaka të bardha", që të vjelin paga të majme në mbi 20 mijë euro dhe të blejnë prona nëpër Holandë, duke shpresuar që t'i hetojnë e gjykojnë shqiptarët sa më gjatë që të munden.

Sikur të mos ishin fshehur pas stigmës speciale "ndërmarrje e përbashkët kriminale", as aktakuza për shumicën nuk do të mund të ngrehnin. Por, duke mos pasur sesi t'u qepeshin ndryshe, veçanërisht pas rënies së pretendimeve të Dick Martyt, e gjetën këtë "model" për t'i goditur edhe themeluesit e UÇK-së, që si politikanë janë edhe themelues të shtetit të Kosovës, për t'i larguar përkohësisht dhe padrejtësisht nga skena politike, deri sa bashkësia ndërkombëtare t'i kryejë edhe do punë të vetat në Kosovë.

Kosova i ka vuajtur gjatë pasojat e trillimeve të Dick Martyt, i cili, po ashtu, ishte anëtar i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës dhe raportues i saj. Ndërsa, aktualisht, po vazhdon t'i vuajë pasojat e episodit të radhës së Bashkimit Evropian, si vazhdimësi e administrimit të padrejtësisë. Pretendimet e Dick Martyt janë hetuar shumë herë nga ekipe të ndryshme të hetuesve ndërkombëtarë dhe kurrë nuk kanë arritur t'i konfirmojnë. Por, duke i shfrytëzuar pikërisht ato pretendime, bashkësia ndërkombëtare pa e ndjerë aspak peshën e fajit dhe përgjegjësisë për ato trillime evropiane, imponuan edhe Gjykatën Speciale, ku tash ato as që i kanë përfshirë në aktakuzë.

Ndonëse pa asnjë simbol shtetëror të Republikës së Kosovës, Gjykata Speciale në Hagë formalisht është e jona, por dihet botërisht që ajo më shumë ka bashkëpunim me autoritetet e Serbisë, se me të Kosovës. Kjo nuk është aspak e re për publikun, sepse bashkëpunimi i drejtësisë ndërkombëtare me drejtësinë kosovare asnjëherë nuk është zhvilluar dyanshëm dhe simetrikisht.

Bashkësia ndërkombëtare nuk ka pasur bashkëpunim efektiv as me gjyqësinë vendore për krimet e luftës. Qysh nga transferimi i dosjeve dhe informacioneve të Tribunalit të Hagës për krimet në ish-Jugosllavi, në përputhje me Strategjinë e Kompletimit, nuk ka pasur asnjë transfer tek institucionet e Kosovës. Ndërsa, 11 dosje i janë transferuar Bosnje e Hercegovinës, 1 dosje Kroacisë dhe 1 dosje Serbisë. Tek vonë tash, pas themelimit të Gjykatës Speciale dhe rënies drastike të kredibilitetit të EULEX-it, kanë nisur disa transferime të lëndëve për krime lufte në Prokurorinë Speciale të Kosovës.

Nëse Kosova sot na paska deficit në gjyqësor, pikë së pari ky është dështim i vetë faktorit ndërkombëtar që administroi me drejtësinë plot dy dekada në vendin tonë. UNMIK-u dhe EULEX-i, ndër të tjera, kishin përgjegjësi t'i zhvillonin dhe fuqizonin kapacitetet e institucioneve tona të drejtësisë. Dhe, nisur nga fakti që nuk po u besojnë institucioneve që vetë i kanë ndërtuar, pavarësisht investimeve qindra milionëshe, bashkësia ndërkombëtare po e konfirmon vetë dështimin e saj.

Sot, po kjo bashkësi ndërkombëtare, duke na e dhënë shembullin më të keq sesi drejtësia ndërkombëtare është e politizuar, më ndërhyrjet e saj na e nxori kohën nga kyçet edhe në Kosovë. Megjithatë, ajo si duket nuk e ka kuptuar që reformimi i skenës politike nuk mund të bëhet asnjëherë me ndërhyrje të jashtme, por me rigjenerimin e kuadrove të partive politike dhe institucioneve publike.

Tash kur padrejtësia është bërë pasqyrë e bashkësisë ndërkombëtare në Kosovë, ka ardhur koha që edhe vetë ta rindërtojnë të kuptuarit e kohës së tyre.






Sport




# Ballkani kryeson në elitë, Trepça '89 i hakmerret Besës

Klubi i futbollit Ballkani, falë tri pikëve që mori ndaj Drenicës, është rikthyer përkohësisht në vendin e parë në Superligë, ndërsa Trepça '89 i është hakmarrë Besës për humbjen që i kishte shkaktuar në muajin tetor të vitit të kaluar



**SUPERLIGA - Java 23**

Besa-Trepça '89 1-2
Ballkani-Drenica 2-1

Të shtunën takohen:
13:00 Prishtina - Llapi
13:00 Gjilan - Arbëria

Të dielën takohen:
13:00 Feronikeli - Drita

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 5 MARS - Gjashtë gola janë shënuar në dy ndeshjet e para të javës së 23-të në Superligën e Kosovës në futboll, kurse fitues kanë dalë Ballkani dhe Trepça '89 në përballje me Drenicën, përkatësisht Besën e Pejës. Ballkani e mposhti Drenicën (2-1) dhe në këtë mënyrë e vazhdon garën për titull të kampionit, kurse kuqezinjtë duhet të luftojnë shumë për mbijetesë. Në minutën e 40 Arbër Hoxha realizoi një gol të bukur dhe në fillim të pjesës së dytë Bajram Jashanica e shtoi epërsinë e vendasve në 2-0, kurse krejt çfarë arriti Drenica në këtë ndeshje ishte goli i shënuar nga Dardan Rogova në minutën e 86. Pas kësaj ndeshje, Ballkani rikthehet përkohësisht në krye të Superligës me 48 pikë. Kuqezinjtë nga Skenderaj renditen në vendin e parafundit me 24 pikë. Në ndeshjen tjetër që u zhvillua të premten, Trepça '89 e mposhti Besën (1-2). Robert Rrahmani shënoi golin e parë në pjesën e parë të ndeshjes, kurse Halili i Besës e barazoi rezultatin në 1-1. Në minutën e 62-të, Muharrem Jashari e vulosi rezultatin final 1-2. Pas tri pikëve të reja, 89-shi zë vendin e pestë me 32 pikë, kurse Besa është e fundit dhe mbetet në kuotën e 7 pikëve.

## Sot derbi Prishtina - Llapi

Derbi i javës së 23-të në elitën e futbollit të Kosovës zhvillohet sot (e shtunë) në stadiumin "Fadil Vokrri" në mes të Prishtinës dhe Llapit. Këto dy klube janë në formë të mirë në sezonin pranveror dhe synojnë ta marrin maksimumin e pikëve. Llapi në ndeshjen e kaluar e mposhti Ballkanin, kurse për ndeshjen e radhës Tahir Batatina është optimist se Llapi do të dalë me rezultat pozitiv, ani pse kryeqytetasit janë skuadra më në formë për momentin në ligë. "Nëse e shohim ecurinë pozitive të klubit dhe triumfin në tri ndeshje të forta, besoj se, sikurse edhe në të kaluarën, në stadiumin 'Fadil Vokrri' do të marrim rezultat pozitiv. Në këtë stadium ndihem sikurse që luajmë në shtëpinë tonë, prandaj jemi të gatshëm ta japim maksimumin dhe t'ia arrijmë qëllimit ndaj një klubi shumë të fortë dhe që po kalon formën më të mirë në ligë", ka deklaruar Batatina për "Epoka e re".
Sot zhvillohet edhe ndeshja në mes të Gjilanit dhe Arbërisë.

## SHKURT

### Peja transferon Shoshin

Skuadra e Pejës në basketboll e ka transferuar basketbollistin e njohur Lis Shoshi. Me transferimin e Lisitit, klubi pejan synon të jetë më i miri në vend. "Qershia mbi tortë për këtë sezon, rikthimi i Lis Shoshit nga lëndimi dhe bashkëngjitja e tij me ekipin me qëllim që të jemi më të mirët. Lisi nuk ka nevojë për prezantim sepse sukseset e tij që në moshë të re dëshmojnë cilësitë e lojtarit. Jemi të lumtur ta kemi përsëri në shtëpi", thuhet në njoftimin e KB Peja.

### Shala transferohet te Stabaeku

Reprezentuesi i Përfaqesues së Kosovës, Herolind Shala është bërë me skuadër të re. Dy sezonet e fundit mesfushori ka luajtur në skuadrën norvegjeze, Valerenga, ai siguroi vendin e tretë vitin e kaluar me skuadrën nga Oslo. Tani ai transferohet disa kilometra në perëndim të Oslos, dhe do të veshë fanellën e Stabaek për sezonin e ardhshëm. Shala ishte pjesë e Sparta Prague në Çeki, Kasimpasa në Turqi dhe Lungby para se të transferohej në Norvegji.

### Dervishi emërohet trajner i Drenasit

Ramiz Dervishi edhe zyrtarisht është emëruar trajner i skuadrës së Drenasit që garon në Ligën e Parë. Lajmi është konfirmuar nga faqja zyrtare e këtij klubi, kurse trajneri Dervishi në të kaluarën me sukses ka punuar në skuadrën e Feronikelit. "Stafit tonë teknik të KF Drenasi i është bashkuar edhe trajneri i mirënjohur Ramiz Dervishi i cili është i njohur për kontributin e tij në sport në komunën tonë. Kryetari i klubit, anëtarët e kryesisë, trajneri dhe të gjithë lojtarët i uruan mirëseardhje Dervishit, i cili tani e tutje të gjitha kapacitetet do t'i vë në funksion të klubit tonë. Duke e pasur parasysh se KF Drenasi çdo ditë e më shumë është duke sjell një frymë të re me ambicie të reja, atëherë ndihma e Dervishit është shumë e nevojshme", thuhet në njoftimin e KF Drenasi.

## KEDS-i, sponsor i FFK-së

PRISHTINË, 5 MARS - Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, sot priti në takim drejtorin Ekzekutiv të Divizionit të Rrjetit KEDS, Alpin Dogan, me bashkëpunëtorët e tij, e ku i pranishëm ishte edhe sekretari i përgjithshëm i FFK-së, Eroll Salihu. Me këtë rast u nënshkrua edhe marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet Federatës së Futbollit të Kosovës dhe kompanisë KEDS. Të dyja palët u pajtuan për partneritet në disa fusha, e të cilat janë të rëndësishme për zhvillimin e futbollit të Kosovës, njëherësh janë me interes të dyanshëm. "Karakteri primar i këtij memorandumi është sponsorizimi, me ç'rast KEDS do ta ndihmojë FFK-në për sigurimin e mjeteve teknike, siç është instalimi i një trafoje me linjë të veçantë për Kampin Edukativ Sportiv në Hajvali. Partneriteti me KEDS-in mundëson edhe lehtësimin e tarifave të energjisë elektrike në stadiumin 'Fadil Vokrri' në Prishtinë, si dhe lehtësira në të gjitha aspektet të cilat i përkasin kompanisë KEDS. Si kundërvlerë kjo kompani tash e tutje do të jetë sponsore zyrtare dhe do të ketë hapësirat e saj reklamuese në të gjitha aktivitetet e FFK-së", thuhet në njoftimin e FFK-së.



## ‘Tokio 2020’ do të jetë olimpiada më e nxehtë



TOKIO, 5 MARS - Meteorologët parashikojnë se vera e këtij viti në Japoni do të jetë më e nxehta në histori, një lajm ky që ka trembur jo pak organizatorët e Lojërave Olimpike “Tokio 2020” (23 korrik-8 gusht 2021). Kjo do të krijojë të tjera probleme për një olimpiadë që deri më tani është përfshirë nga shumë të tilla, që sollën edhe shtyrjen e saj me një vit si pasojë e pandemisë Covid-19. Sipas Universitetit të Tokios, temperaturat e këtij viti do të jenë tepër të larta në periudhën korrik-gusht, duke barazuar temperaturat e Olimpiadës së vitit 1984. Problem nuk do të jetë vetëm temperatura, por edhe lagështia, që do të jetë në norma përtej limitit. Herën e fundit që olimpiada është zhvilluar në Tokio (1964), ajo u shty në tetor pikërisht për këtë arsye.

# Sot përballen Vëllaznimi - Rahoveci dhe Ylli - Ponte Prizreni

PRISHTINË, 5 MARS - Në fundjavë do të zhvillohet xhiroja e 22-të në FIVE STAR Superligën e Kosovës në basketboll. Takimi më interesant i kësaj xhiro do të jetë ndërmjet Golden Eagle Yllit dhe Ponte Prizrenit, të dyja skuadrat që kanë grumbulluar nga 35 pikë apo 14 fitore dhe shtatë humbje, duke u renditur në vendin e parë, përkatësisht të dytë. Takimi pritet të jetë shumë interesant dhe do të mësohet se kush do të kryesojë e vetme në tabelë.

Vëllaznimi që mundi Sigal Prishtinën dhe Pejën, do të mundohet të vazhdojë me rezultate pozitive, ku në këtë xhiro do të ballafaqohet me Rahovecin, që hyn i motivuar pas fitores ndaj Golden Eagle Yllit në fundjavë. Kuqezinjtë kanë gjashtë fitore dhe 15 humbje, derisa “Vreshtarët” 13 fitore dhe tetë humbje. E diela është e rezervuar për skuadrat rivale në basketbollin e Kosovës. Trepça do të ballafaqohet me Bashkimin. Mitrovicasit janë në formë shumë të mirë dhe këtë formë të mirë do të mundohen ta vazhdojnë edhe përballë prizrenasve, që në dy xhirot e fundit pësoi humbje nga Ponte Prizreni dhe Sigal Prishtina. Trepça ka tetë fitore dhe 13 humbje, derisa Bashkimi 10 fitore dhe 11 humbje. Përballja e fundit është ndërmjet Sigal Prishtinës dhe Pejës, dy rivalët e vjetër. “Bardhekaltrit” pësuan nga Vëllaznimi, por fituan ndaj Bashkimit, kurse pejanët hyjnë me ndryshime, ku së fundi si trajner është angazhuar ish-trajneri i prishtinasve, Dragan Radoviq. Prishtinasit kanë shtatë fitore dhe 14 humbje, kurse pejanët 12 fitore dhe nëntë humbje.



**SUPERLIGA - Java 22**

**Të shtunën takohen:**
**17:00 Vëllaznimi - Rahoveci**
**19:00 Golden Eagle Ylli - Ponte Prizreni**

**Të dielën takohen:**
**17:00 Trepça - Bashkimi**
**19:00 Sigal Prishtina - Peja**

# Clippersat befasohen nga Washingtoni

UASHINGTON, 5 MARS - Washington Wizards është rikthyer te fitoret pas dy humbjeve radhazi në NBA. Në ndeshjen e zhvilluar në “Capital One” arena të Washingtonit, Wizards ka shkaktuar befasi duke e mposhtur Los Angeles Clipppersi me dy pikë diferencë, 119-117. Ka qenë një ndeshje me shumë kthesa në rezultat, por në fund vendësit fituan me meritë falë dyshes fantastike Breadley Beal dhe Russell Westbrook. Beal e mbylli takimin me 33 pikë, shtatë kërcime e tre asistime duke konfirmuar formën e lartë që po kalon këtë edicion. Ndërkohë me lojë të mirë te vendësit u dallua edhe Rusell Westbrook me 27 pikë, 11 kërcime e nëntë asistime. Kawhi Leonard me 22 pikë ishte më efikasi te mysafirët, por që nuk mjaftoi paraqitja e tij e mirë të marrë fitore. Për Wizardsin kjo ishte fitorja e 14 këtë edicion kundër 20 humbjeve, kurse Clippersi ka bilanc prej 24-14 në të mirë të fitoreve.



**Rezultatet**

| | |
|---|---|
| Boston Celtics - Toronto Raptors | 132-125 |
| Washington Wizards - LA Clippers | 119-117 |
| New York Knicks - Detroit Pistons | 114-104 |
| Indiana Pacers - Denver Nuggets | 103-113 |
| Memphis Grizzlies - Milwaukee Bucks | 111-112 |
| NO Pelicans - Miami Heat | 93-103 |
| San Antonio Spurs - Oklahoma City Thunder | 102-107 |
| Phoenix Suns - Golden State Warriors | 20-98 |
| Portland Trail Blazers - Sacramento Kings | 123-119 |

## SHKURT

### Sërish lëndohet Strakosha

Lazio vijon përgatitjet për transfertën me Juventusin, e planifikuar për të shtunën në mbrëmje, teksa portieri shqiptar Thomas Strakosha është ndalur sërish për shkak të një dëmtimi. Ka qenë vetë klubi bardhekaltër që ka njoftuar se gardiani kuqezi nuk është stërvitur me ekipin për shkak të një problemi muskulor dhe prania e tij në Torino duket thuajse e pamundur. Të dëmtuar për Lazion vijojnë të mbeten edhe Felipe Luiz e Manuel Lazzari, të cilët mungojnë prej disa javësh, ndërsa skuadrës iu bashkua Adam Marusiç.

### Woods, për aksidentin: Nuk mbaj mend asgjë

Lajme të reja mbi aksidentin e Tiger Woods. Legjenda e golfit u përplas më 23 shkurt në një nga autostradat e Kalifornisë në orët e para të mëngjesit. Shumë aludime u bënë për shkakun e ngjarjes, ku u përfol se Woods mund të kishte qenë i pirë, me shpejtësi apo dhe në gjumë. Mirëpo, ka qenë vetë ai që ka deklaruar që nuk mban mend asgjë nga ngjarja, duke shtuar akoma dhe më shumë pikëpyetjet për mënyrën se si ndodhi humbja e kontrollit të automjetit. Tiger i ka thënë policisë se nuk e mban mend fare përplasjen, madje as makinën. Policia ende nuk ka marrë gjak nga Woods për të bërë të tjera testime, pasi supozohej se në ato momente ai ka qenë i vetëdijshëm dhe i kthjellët. Kujtojmë që Tiger ka udhëtuar vetëm për 12 minuta përpara se të dilte nga rruga. Në ditët në vijim pritet zbardhja e plotë e ngjarjes, por rëndësi ka që ylli i golfit pësoi vetëm një thyerje të këmbës dhe asgjë më shumë.

### Mario Rui përjashtohet nga stërvitja

Tensione te Napoli pas barazimit 3-3 kundër Sassuolos është i madh. Mario Rui nuk e përfundoi stërvitjen me ekipin ditën e djeshme, pasi u përzu nga Gennaro Gattuso dhe shkoi në dhomën e zhveshjes para kohe. Në bazë të vendimit të trajnerit, futbollisti pati një sjellje të padëshiruar gjatë seancës stërvitore. Kjo nuk është hera e parë që Gattuso merr masa ndaj mbrojtësit të majtë portugez. Në ndeshjen e parë kundër Bolognas, ai u dërgua në tribuna për shkak të mungesës së angazhimit. Gjatë fundjavës, klubi napolitan do ta sfidojë Bolognan në ndeshjen e fazës së dytë në stadiumin “Diego Maradona”.

### Përfundon sezoni për Ozilin

Mesut Ozil u largua nga Arsenali në janar dhe iu bashkua skuadrës së Fenerbahçes, me dëshirën për ta fituar titullin kampion në Turqi. Gjithsesi fantazisti është i pafat, pasi në ndeshjen e gjashtë me verdhezinjtë u dëmtua dhe ka mbyllur sezonin. Në sfidën kundër Antalyasporit, Ozil la fushën e lojës në fillim të pjesës së dytë dhe sot ai njofton se ka këputur ligamentin, një dëmtim që e lë jashtë fushave të blerta për rreth gjashtë muaj. “Jam me të vërtetë i mërzitur dhe i trishtuar që nuk do të jem në gjendje ta ndihmoj ekipin tim në ndeshjet në vazhdim për shkak të një këputje të ligamentit të jashtëm. Mund të kishte qenë edhe më keq, por do të përpiqem dhe do të bëj gjithçka që të kthehem në fushë sa më shpejt. Faleminderit për mesazhet dhe mbështetjen!”, ka shkruar Ozili në llogarinë e vet në “Twitter”.

## Kalendari i ri për sezonin 2021 në Formula 1

